

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6863
E premte, 31 mars 2023
çmimi 0.40 €

Ish-kryeshefi i PTK-së:
Mburrja e kryeministrit
me Telekomin e Kosovës
është qesharake | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AEROPORTI I GJAKOVËS ËSHTË DUKE U FUNKSIONALIZUAR PËR QËLLIME
TË MBROJTJES, BABAJ I BOKËS DO TË SHNDËRROHET NË ZONËN
OPERACIONALE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS | FAQE 4-5

AEROPORTI I GJAKOVËS PO FUNKSIONALIZOHET PËR USHTRINË



Autoritetet në Kosovë kanë bërë me dije se kanë përfunduar të gjitha procedurat për shpronësimin e tokave në Babaj të Bokës që gjendet në komunën e Gjakovës dhe në Aeroportin e

Gjakovës. Shpronësimi i këtyre tokave dhe kalimi i tyre si pronë e Qeverisë së Kosovës do të mundësojnë fillimin e zbatimit të projekteve strategjike për ushtrinë e Kosovës në këto dy

zona, kanë bërë me dije në një konferencë për medie të enjten ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu

**KOALICIONI
LV - AAK, VALË-VALË,
VEÇ SA S'KA DALË**

FAQE 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



**RAFUNA:
AFARISTËT
TANË KËRKOJNË
HEQJEN E
PENGESAVE
GJATË EKSPORTIT
NË SERBI**

FAQE 7



AKTUALE



**UKË RUGOVA LIROHET
NGA AKUZA PËR KRIM TË
ORGANIZUAR ME VIZA ITALIANE** F. 6

**"MARSHOJMË PËR DREJTËSI"
MERR MBËSHTETJEN EDHE
TË SBASHK-ut** F. 7

**HULUMTIM: ZVICRA, VENDI
MË I PËLQYER NGA QYTETARËT
E KOSOVËS** F. 5

EKONOMI



**A MUND TË RINGJALLEN TELEKOMI
DHE TREPÇA NGA FONDI SOVRAN?** F. 8

SPORT



**NDËRRON JETË FUTBOLLISTI
15-VJEÇAR LEON SYLA** F. 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja, 690 milionë dollarë programe për ta fuqizuar demokracinë në mbarë botën

WASHINGTON, 30 MARS - Presidenti Joe Biden në takimin e dytë për Demokracinë ka premtuar se Shtetet e Bashkuara do të investojnë 690 milionë dollarë gjatë vitit që vjen për t'i fuqizuar programet e demokracisë në mbarë botën. "Po ndryshojmë rrjedhën këtu. Siç e themi shpesh, gjendemi këtu në një pikë kthese të historisë, kur vendimet që marrim sot do të ndikojnë te kursi i botës sonë për të paktën disa dekada në vazhdim", ka theksuar presidenti Biden.

Shtëpia e Bardhë vuri në dukje se Shtetet e Bashkuara dëshirojnë në veçanti që ta bëjnë "teknologjinë të punojë në favor të demokracisë dhe jo kundër saj". Në këtë forum, kryeministrat e tetë vendeve evropiane nënshkruan një letër të hapur drejtuar drejtuesve të kompanive kryesore të medieve sociale duke u bërë atyre thirrje që të tregohen më agresivë në bllokimin e përhapjes së informacionit fals në platformat e tyre. Letra u nënshkrua nga udhëheqësit e



Ukrainës, Moldavisë, Polonisë, Republikës Çeke, Estonisë, Letonisë, Lituanisë dhe Sllovakisë. "Presidenti Biden e ka quajtur

betejën për të fuqizuar qeverisjen demokratike në vend dhe jashtë tij si sfidën përcaktuese të kohërave tona", ka bërë me dije

Shtëpia e Bardhë, duke theksuar tutje se: "Kjo është për shkak se demokracia, qeverisja transparente dhe e përgjegjshme

përpara popullit, mbeten mënyra më e mirë për të arritur paqe afatgjatë, begati dhe dinjitetin njëzëor".

BE-ja arrin marrëveshje ambicioze për energji të ripërtërishme

BRUKSEL, 30 MARS - Parlamenti i Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të këtij blloku e aritën marrëveshje që deri në vitin 2030 pothuajse ta dyfishojnë përqindjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë në konsumin e përgjithshëm të bllokut 27-vendësh.

Kjo marrëveshje e përkohshme politike synon ta rrisë përqindjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë, si era dhe dielli, në 42.5 për qind, nga 22 për qind që është aktualisht.

Marrëveshja u bë e ditur përmes një deklarate të Këshillit të BE-së, e cila përfaqëson qeveritë kombëtare të bllokut.

Më herët, BE-ja kishte synuar që



deri në vitin 2030 të mbulonte 32 për qind të konsumit të përgjithshëm të energjisë përmes burimeve të ripërtërishme. BE-ja ka vendosur këtë synim

ambicioz pasi mësyn të bëhet një ekonomi "neutrale klimatike" deri në vitin 2050, përmes uljes së emetimeve neto të gazrave serrë në zero. Aktualisht ka dallime të

mëdha mes vendeve anëtare të BE-së në nivelin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë. Suedia kryeson 26 vendet anëtare me 63 për qind të konsumit të mbuluar nga burimet e ripërtërishme. Ndërsa, në Luksemburg, Maltë, Holandë dhe Irlandë, burimet e ripërtërishme mbulojnë vetëm më pak se 13 për qind të konsumit.

Kjo marrëveshje vjen gjithashtu pasi BE-ja ka tentuar të ulë varësinë e saj nga karburantet fosile ruse pasi Moska ndërpreu furnizimet me gaz vitin e kaluar dhe bllokua vendosi kufizime për naftën e papërpunuar dhe produktet e tjera të naftës nga Rusia.

Për t'i arritur këto synime, BE-ja do të duhet të bëjë investime të mëdha në prodhimin e energjisë nga era dhe dielli, si dhe të shtojë prodhimin e gazrave të rinovueshme dhe ta përforcojë rrjetin e energjisë në Evropë.

Komisioni Evropian ka thënë se deri në vitin 2030 do të nevojiten investime shtesë prej 113 miliardë eurosh në energjinë e ripërtërishme dhe infrastrukturën e hidrogjenit, nëse vendet e BE-së duan t'i japin fund varësisë së tyre nga karburantet fosile ruse.

Marrëveshja duhet të miratohet nga Parlamenti i BE-së dhe vendet e BE-së për t'u bërë ligj, por kjo procedurë është zakonisht një formalitet.

Papa Françesku hospitalizohet pas problemeve me frymëmarrje

ROMË, 30 MARS - Shkaku i një infeksioni në organet e frymëmarrjes, Papa Françesku do të duhet t'i kalojë disa ditë në një spital në Romë, ka bërë të ditur Vatikanin.

Në deklaratën e publikuar nga Vatikanin thuhet se 86-vjeçari kishte pasur vështirësi në frymëmarrje gjatë ditëve të fundit, por se nuk ka Covid-19.

Më tutje, në deklaratë thuhej

se ai ka nevojë për "disa ditë terapi adekuate mjekësore spitalore". "Papa Françesku është prekur nga mesazhet e shumta që ka marrë dhe shpreh mirënjohjen e tij për afërsinë dhe lutjet", thuhet në deklaratë.

Stafi i tij më i afërt, përfshirë këtu edhe sigurimin, raportohet të ketë qëndruar me të në spital gjatë orëve të para të së enjtes, sipas një burimi të BBC.

Kjo është periudha më e ngarkuar e vitit për Papa Françeskun, pasi që janë planifikuar shumë evente dhe shërbime para fundjavës së Pashkëve.

Këtë fundjavë ishte planifikuar një meshë e madhe, ndërsa festimet e Javës së Shenjtë dhe Pashkëve gjatë javës së ardhshme. Në agjendën e tij ishte planifikuar edhe një vizitë në Hungari në fund të prillit.



Universiteti më i madh publik amerikan ASU vjen në Kosovë, partner i Kolegjit Universum

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MARS - Kolegji Ndërkombëtar Universum (UNI) dhe Universiteti Shtetëror i Arizonës (ASU) kanë zyrtarizuar partneritetin strategjik mes tyre në një ngjarje që është mbajtur në Prishtinë. Ky bashkëpunim bën të mundur që studentët të marrin edukim të klasës botërore në Kosovë, fuqizuar nga Arizona State University, universiteti më i madh publik në ShBA me mbi 150 000 studentë.

Sipas US News & World Report, aktualisht Arizona State University (ASU) renditet si universiteti numër një më inovativ në ShBA për tetë vjet radhazi (2016 -2023).

Ndërsa UNI zgjeron reputacionin e tij si institucioni më i ndërkombëtarizuar i arsimit të lartë në Kosovë, ky partneritet i ri do të ndihmojë në hapjen e mundësive të reja duke kultivuar më tej programet dhe praktikatat ekzistuese dhe do t'u mundësojë studentëve të marrin një arsim të klasës botërore në Kosovë, me një çmim të përballueshëm.

Ndryshe nga çdo iniciativë tjetër e arsimit të lartë, ky partneritet strategjik e transformon UNI-në në një lider rajonal me aftësi të jashtëzakonshme operationale dhe digjitale dhe fuqizon të gjithë studentët dhe stafin e UNI-t përmes



ofririmit të qasjes në arsimin e klasës botërore në Kosovë.

Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit me universitetin amerikan, presidentja Vjosa Osmani ka deklaruar se përmes lansimit të partneritetit strategjik me Universitetin Shtetëror të Arizonës raportet tona do të thellohen

gjithnjë e më shumë.

Partneriteti i ri bashkëpunues i UNI-t me ASU-në do të sigurojë që studentët dhe mësimi të mbeten në qendër të fokusit të universitetit, duke hapur dyer të reja për studentët që të kenë qasje në ato që ofron kurrikula e ASU-së, mundësitë kërkimore-shkencore, si dhe

mundësitë e reja për bashkëpunim dhe mësim të ndërsjellë për profesorët dhe stafin e UNI. Përveç ofririmit të programeve me diploma të dyfishta për studentët, gjithashtu do të krijohet një lidhje më e gjerë me industrinë dhe ndërmarrësinë globale. "Cilësia, inovacioni, ndërkombëtarizimi dhe përvoja

studentore janë vetëm disa nga shtyllat që kanë definuar institucionin tonë për gati njëzet vjet, duke formësuar mënyrën se si ne mendojmë t'u shërbejmë sa më mirë studentëve tanë sot dhe dekadave në vijim", ka thënë Alejtin Berisha, president i UNI - Kolegjit Ndërkombëtar Universum.

Rafuna: Afaristët tanë kërkojnë heqjen e pengesave gjatë eksportit në Serbi

PRISHTINË, 30 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, tha për "Radion Evropa e Lirë" se Oda Ekonomike e Serbisë duhet të bëjë presion te qeveria serbe që t'i largojë pengesat administrative me të cilat përballen afaristët e Kosovës gjatë eksportit të mallrave në Serbi. Këto komente Rafuna i bëri në Shkup, ku po merr pjesë në takimin e Forumit Investues të Dhomave të Ballkanit Perëndimor. Ky takim ka për temë "bashkëpunimin mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor". "Ideja është që Oda Ekonomike e Serbisë të bëjë presion te qeveria serbe që t'i eliminojë barrierat që i kanë



afaristët kosovarë. Në të kundërtën, ata [gjatë transportit të mallrave në Kosovë] do të

ballafaqohen me pengesat që i kemi ne", tha ai. Që nga shpallja e pavarësisë se

Kosovës në vitin 2008 afaristët kosovarë janë ballafaquar me barrierat të ndryshme në aspektin e shkëmbimit të mallrave me Serbinë, pasi Beogradi zyrtar nuk e njeh Kosovën dhe rrjedhimisht as dokumentet që lëshohen nga institucionet e saj.

Një nga pengesat me të cilat përballen prodhuesit në Kosovë është mosnjohja e certifikatës së origjinës së produkteve ku shkruan "Made in Kosova". Me këtë mbishkrim, prodhuesit e Kosovës nuk kanë mundësi të kalojnë as transitin nëpër territorin e Serbisë.

Kurse tregu i Kosovës, tha Rafuna, është i mbushur me produkte nga

shteti i Serbisë. "Kosova nuk e ndalon që të hyjë në Kosovë asnjë produkt që shkruan 'Made in Serbia'. Pra, duhet të bisedohet ose ju t'i bëni gjërat si ne, ose ne si ju, pra kërkesa e afaristëve kosovarë është që mos të kenë pengesa", tha Rafuna dhe shtoi se prodhuesit kosovarë janë të interesuar që të gjejnë një treg rajonal, që më pas të mund të kalojnë në atë evropian. "Është me rëndësi të eliminohen pengesat administrative dhe të shfrytëzohet kostoja e ulët për transportin e mallrave, për faktin se Prishtina është vetëm tri orë larg Beogradit dhe vetëm një orë larg Shkupit", theksoi Rafuna.

Krasniqi: Marrëveshja e Ohrit është e pamjaftueshme dhe mundësi e humbur

PRISHTINË, 30 MARS - Në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari Memli Krasniqi ka pritur në takim ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, të shoqëruar nga Jeeni Laakso nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës dhe Annina Peltonen nga Fondacioni për Paqe "Martti Ahtisaari" (CMI).

Krasniqi ka bërë me dije se në

këtë takim kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe situatën aktuale politike pas pranimit të propozimit evropian nga kryeministri Kurti në Bruksel dhe dakordimit për aneksin e zbatimit të tij në Ohër. "Për ne, kjo marrëveshje, e cila nuk është as finale e as gjithëpërfshirëse dhe që heq dorë nga njohja e ndërsjellë, është e pamjaftueshme dhe

mundësi e humbur për ta përmbyllur konfliktin e ngrirë prej dekadash me Serbinë. Kjo marrëveshje, mbi të gjitha, është rezultat i gabimeve të vazhdueshme të kryeministrit Kurti dhe nuk i arrin qëllimet tona shtetërore e qytetare. Mysafirët i falënderova për vizitën dhe mbështetjen konstante që Finlanda ka dhënë për Republikën e Kosovës", ka theksuar Krasniqi.





AEROPORTI I GJAKOVËS ËSHTË DUKE U FUNKSIONALIZUAR PËR QËLLIME TË MBROJTJES, BABAJ I BOKËS DO TË SHNDËRROHET NË ZONËN OPERACIONALE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Aeroporti i Gjakovës po funksionalizohet për ushtrinë

Autoritetet në Kosovë kanë bërë me dije se kanë përfunduar të gjitha procedurat për shpronësimin e tokave në Babaj të Bokës që gjendet në komunën e Gjakovës dhe në Aeroportin e Gjakovës. Shpronësimi i këtyre tokave dhe kalimi i tyre si pronë e Qeverisë së Kosovës do të mundësojnë fillimin e zbatimit të projekteve strategjike për ushtrinë e Kosovës në këto dy zona, kanë bërë me dije në një konferencë për medie të enjten ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, dhe ai i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, dhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë mbajtur të enjten konferencë për medie në lidhje me projektet strategjike milionëshe që po realizohen në Aeroportin e Gjakovës dhe në Babaj të Bokës.

Ministri Aliu ka folur për procedurat e ndjekura për shpronësimin e pronave të planifikuara për realizimin e këtyre dy projekteve me interes nacional, tejet të rëndësishme në aspektin strategjik për Ministrinë e Mbrojtjes, përkatësisht për nevojat e Forcës së Sigurisë së

Kosovës. “Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për arsye të interesit nacional strategjik, MMPHI përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka marrë përsipër azhurnimin e parcelave të shpronësuara në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme. Me propozimin e Departamentit të Shpronësimit në kuadër të MMPHI, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin përfundimtar nr. 19/67, me datë 09.03.2022 për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve të cilat preken nga ndërtimi i ‘Poligonit kryesor të trajnimeve’ për nevoja të FSK-së. Poligoni përfshin zonat kadastrale: Babaj i Bokës, Shishman i Bokës, Popoc,

Ponoshec, Çerret dhe Devë të komunës së Gjakovës. Ndërsa projekti në Aeroportin e Gjakovës përfshinë zonat kadastrale: Bec, Trakaniq dhe Janosh të Komunës së Gjakovës”, ka thënë ministri Aliu. Ai ka theksuar se shumica e paguar për shpronësimet e këtyre pronave kap vlerën mbi 9 milionë euro, ndërsa të gjitha pronat e shpronësuara tashmë janë bartur në emër të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq ministri Mehaj ka folur për rëndësinë e këtyre dy projekteve në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, destinimi funksional i së cilave do të kontribuojë në mënyrë direkte në avancimin e kapaciteteve profesionale trajnuese të

Ushtrisë së Kosovës, duke bërë kështu hapa të tjerë drejt përmbytjes së standardeve ushtarake të NATO-s. “Kjo formë e bashkëpunimit në mes të dy ministrive tregon qartë se prioriteti ynë është zhvillimi dhe avancimi i Ushtrisë së Kosovës, që mundëson integrim edhe më të shpejtë në NATO. Synimi ynë si Ministri e Mbrojtjes është rritja e kapaciteteve trajnuese për Forcën e Sigurisë së Kosovës, andaj investimi në këto dy projekte infrastrukturore do të bëhet në bashkëpunim me partnerin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Investime milionëshe me profesionistë të fushës për të garantuar që ushtria jonë do t’i ketë të gjitha kushtet për zhvillim të mëtutjeshëm, ushtri me kapacitete të plota mbrojtëse. Kontribuuese në ruajtjen e paqes jo vetëm në vend, por dhe në rajon e më gjerë”, ka thënë Mehaj. Duke folur për projektin e Poligoneve në Babaj të Bokës, ministri Mehaj ka theksuar se sipërfaqja disahektarëshe me poligone të qitjes do të jetë aset i çmuar për trajnimin jo vetëm të

ushtarakëve të FSK-së, por do të jetë në funksion edhe të forcave të shteteve partnere. “Ndërsa investimi në Aeroportin e Gjakovës jo vetëm do ta mundësojë ruajtjen e aseteve dhe funksionalizimin e këtij aeroporti, por edhe modernizimin e tij për t’i përmbytur kësaj nevojat operacionale të FSK-së”, ka thënë ai.

Ministri Mehaj ka theksuar se do të vazhdojnë investimet në mënyrë që FSK-ja të jetë ushtri e gatshme për të shërbyer në çdo mision të NATO-s. “Dua të theksoj se nga dyfishimi i numrit si ushtri brenda dy vjetëve kemi shumëfishuar vlerën e buxhetit të investuar në përgatitjen profesionale të ushtarakëve e në blerjen e armatimeve, ndërsa po vazhdojmë investimet infrastrukturore që FSK-ja të jetë ushtri e gatshme për të shërbyer në çdo mision të NATO-s”, ka thënë Mehaj.

Aeroporti i Gjakovës pas luftës së viteve 1998/99 është rindërtuar nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, përkatësisht nga paqeruajtësit italianë. Deri në

AGK-ja: E rrezikshme dhe e papranueshme gjuha e shefit të stafit të presidentes

PRISHTINË, 30 MARS - Jo për herë të parë, Blërim Vela, shef i stafit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, ka sulmuar mediet e Kosovës pas raportimeve për një vendim të pritshëm të Gjykatës Kushtetuese për deputetë të minoriteteve në Kuvendin e Kosovës, që si zinxhir mund ta vë në pikëpyetje zgjedhjen e presidentes. "Vela në një postim

skandaloz në 'Twitter' thotë se raportimet e medieve të Kosovës 'janë pjesë e luftës speciale të realizuar sipas skemës së përgatitur nga Beogradi dhe të realizuar përmes kriminelëve të veriut dhe sekserëve të tyre, të cilët ndodhën në listën e zezë të ShBA-së'. Kjo është një gjuhë e papranueshme dhe shumë e rrezikshme që rëndon ambientin

e punës së gazetarëve në Kosovë. Për më tepër është vazhdimësi e sulmeve të z. Vela ndaj medieve", thuhet në reagimin e AGK-së. Teksa merr pjesë në Samitin e Demokracisë, AGK-ja i bën thirrje të përsëritur presidentes Vjosa Osmani që përfundimisht t'i ndalojë sulmet ndaj medieve nga kabineti i saj e që shërbejnë si presion në punën e tyre.



Hulumtimi: Zvicra, vendi më i pëlqyer nga qytetarët e Kosovës


PRISHTINË, 30 MARS - Një hulumtim i ri nga dua.com tregon se Zvicra është vendi më i pëlqyer nga kosovarët. Zvicra shfaqet si vendi më i vizituar nga qytetarët e Kosovës (28.75 për qind), përcjell nga Gjermania (21.5 për qind)

dhe Suedia (4.82 për qind). Një pjesë e madhe e përdoruesve (54.77 për qind) kanë shfaqur një preferencë për rajonin gjermanofolës. Çuditërisht, Austria radhitet e katërta në listë menjëherë pas Suedisë, me një

përqindje të përafërt me vendin e pestë, Francën. Hulumtimi ka analizuar të dhënat e më shumë se 160 000 përdoruesve nga Kosova brenda aplikacionit - në të cilin janë gjeneruar mbi qindra mijëra

fluturime - për t'i përcaktuar vendet më të pëlqyera për kosovarët. Përdoruesit e aplikacionit e kanë mundësinë ta përdorin opsionin e fluturimit për ta ndërruar lokacionin nga Kosova në një shtet tjetër, me

mundësi që të njohin shqiptarë të tjerë. Hulumtimi, gjithashtu, zbuloi se grupmoshat që udhëtojnë më së shpeshti janë 25 deri në 34 vjeç, rezultat ky që hodhi dritë mbi preferencat e të rinjve të Kosovës.



vitin 2013 ai është përdorur për mbështetjen e aktiviteteve ushtarake të misionit të NATO-s. Në dhjetor të atij viti, pas një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet qeverive të atëhershme të Italisë dhe Kosovës, Aeroporti i Gjakovës me të gjitha mjetet për operim është transferuar tek autoritetet e Kosovës.

Gjashtë vjet më vonë, me një vendim të Qeverisë së Kosovës, aeroporti i është dhënë në shërbim Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht Forcës së Sigurisë së Kosovës. Aeroporti i Gjakovës gjendet rreth 5 kilometra në veri të qytetit të Gjakovës. Është i vendosur në një hapësirë relativisht të rrafshët -

rreth 400 metra mbi nivelin e detit. Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës i ka bërë atij një auditim në vitin 2016. Në këtë aeroport është e instaluar Kulla mobile e kontrollit të trafikut ajror, e pajisur me sistemet e nevojshme të komunikimit tokë-ajër; aeroporti ka edhe infrastrukturën e furnizimit me

rrymë dhe ujë dhe mjetet për furnizimin e aeroplanëve me karburante. Aeroporti ka një sistem të vetëm piste me një rrugë paralele për taksim. Pista është 1 799 metra e gjatë dhe 30 metra e gjerë. Terminali i aeroportit përbëhet nga hapësirat e terminalit të udhëtarëve dhe mallrave, parkingu i

aeroplanëve, hapësirat për ngarkim dhe shkarkim dhe hapësirat për shërbime të udhëtarëve. Aeroporti i Gjakovës është formuar dhe funksionalizuar që pas Luftës së Dytë Botërore për nevoja të agrokulturës. Në vitet '90 ai ka pushuar së funksionuari deri në kohën kur është marrë nga KFOR-i.

Rizvanolli në Gjermani takon përfaqësues të "Siemens Energy": I mirëpresim investimet tuaja

BERLIN, 30 MARS - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka takuar përfaqësues të "Siemens Energy", me të cilët ka biseduar për investimet në energji. Ajo ka thënë se Kosova ofron potencial të

pashfrytëzuar sa iu përket investimeve të Kompanisë Globale të Energjisë së Rinovueshme. "Kosova ka shumë potencial të pashfrytëzuar për zhvillim të burimeve të ripërtërishme të

energjisë. Ishte kënaqësi të shkëmbej me "Siemens Energy" mbi mundësitë për investime që ofron sektori ynë i energjisë. Jemi entuziastë t'i mirëpresim në Kosovë", ka shkruar Rizvanolli në "Facebook".



Ukë Rugova lirohet nga akuza për krim të organizuar me viza italiane, dënohet për armëmbajtje pa leje

PRISHTINË, 30 MARS - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues lidhur me veprën penale krim i organizuar ndaj ish-deputetit Ukë Rugova, ish-ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Astrit Haraqija, Qefser Bahollit dhe Izet Beqirit, ndërsa aktgjykim dënues për armëmbajtje pa leje ndaj Rugovës, Bahollit dhe Beqirit. Ata ngarkoheshin se duke vepruar si grup kriminal, për qëllime të përfitimit material, i kanë pajisur qytetarët në mënyrë të jashtëligjshme me viza shengen nga Ambasada Italiane në Prishtinë. Aktgjykimi ndaj të akuzuarve në këtë rast u shpall të enjten nga kryetarja e trupit gjyqës, Fatime Dërmaku, raporton "Betimi për Drejtësi". Sipas aktgjykimit, për

Ukë Rugovën gjykata ka bërë ricilësimin nga paragrafi 2 në paragrafin 1 për veprën penale armëmbajtje pa leje, pasi që të njëjtin e gjeti përgjegjës për posedimin e dy revolveve. Kurse edhe Izet Beqirin dhe Qefser Bahollin i gjeti përgjegjës për armëmbajtje pa leje. Ndaj Ukë Rugovës gjykata shpalli dënim me gjobë në shumën prej 6 000 euro për armëmbajtje pa leje, kurse ndaj Beqirit dhe Bahollit dënim me gjobë për secilin veç e veç nga 3 500 euro për të njëjtën veprë penale. Kurse për Florjan Petanin është refuzuar akuza, pasi që Prokuroria Speciale ka hequr dorë nga ndjekja penale. Gjykatësja Dërmaku tha se ankesa ndaj aktgjykimit sipas Kodit të ri është 30 ditë.



KEDS-i vazhdon investimet për shërbime sa më kualitative në Obiliq



OBILIQ, 30 MARS - Në komunën e Obiliqit në pjesën perëndimore shtrihen mbi 170 shtëpi të cilat, falë investimeve të KEDS-it, tashmë kanë rrjet të ri si të tensionit të mesëm dhe të tensionit të ulët. Ky investim i bërë nga kompania KEDS dhe implementuar nga punëtorët e saj do të sjellë furnizim stabil dhe të qëndrueshëm për konsumatorët të kësaj ane. Në këtë pjesë të Obiliqit, që shtrihet përkaj Termocentralit "Kosova B", janë vendosur 143 shtylla të reja, 650 përçues, rreth 10 mijë metra kablo, asete këto që do ta përmirësojnë dukshëm cilësinë e shërbimeve të energjisë elektrike. Drejtori i Sistemit të Operimeve në KEDS, Bujar Jupaj, ka

theksuar se investimet e tilla do të mundësojnë ofrimin e shërbimeve kualitative për konsumatorët tanë. "Duke marrë parasysh se KEDS-i ka trashëguar një rrjet të vjetër të energjisë elektrike, janë ndërmarrë veprime të menjëhershëm të investimeve në nënstacione për modernizimin dhe digitalizimin e rrjetit për të vetmen arsye, që konsumatorët të përfitojnë shërbime më efikase dhe më kualitative të energjisë elektrike", ka thënë ai. Investime të tilla të KEDS-it janë duke vazhduar edhe në lagje, fshatra e qytete të territorit të Kosovës, duke vendosur pajisjet më bashkëkohore dhe pajisje të fjalës së fundit të teknologjisë.

"Qatar Charity" shpërndau 300 pako ushqimore dhe miell për familjet malishevase

MALISHEVË, 30 MARS - Nuk është ndihma e parë e "Qatar Charity" në komunën e Malishevës. Kjo organizatë me programin e vet përmes hapjes së puseve për ujë të pijshëm për familjet të cilat kanë nevojë po vazhdon programin e ndihmave edhe me

shpërndarjen e 300 pakove ushqimore dhe miellit për familjet në nevojë. E tëra kjo ndihmë po bëhet edhe me asistimin e zyrtarëve të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, të cilët kanë falënderuar Qatar Charity për këto ndihma që po i jep për

familjet në nevojë të komunës së Malishevës në muajin e shenjtë të Ramazanit. Përfaqësuesi i "Qatar Charity" ka theksuar se projekti për pusët me ujë të pijshëm dhe kjo me pako ushqimore e miell nuk do të jenë ndihmat e vetme.



Ish-kryeshefi i PTK-së: Mburrja e kryeministrit me Telekomin e Kosovës është qesharake



PRISHTINË, 30 MARS - Ish-kryeshefi i PTK-së, Shyqyri Haxha, i ka reaguar kryeministrit Albin Kurti, i cili një ditë më parë është krenuar me këtë kompani publike. Në "Facebook" Haxha ka vlerësuar se mburrja e kryeministrit me Telekomin e Kosovës është qesharake. "Mburrja me Telekomin e Kosovës nga kryeministri Kurti është qesharake. Nuk mund të mburresh me një kompani apo

menaxhment steril që ke vendosur vetë dhe si qeveri i ke ndarë me dhjetëra miliona, keni larguar punëtorë nga puna, si dhe kualiteti i shërbimit është për t'u dëshiruar. Shikoni sa miliona i ka dhënë qeveria Kurti Telekomit, ka larguar mbi 300 punëtorë, kryesisht punëtorë vitalë. Me mbajt 'gjallë' kompaninë me pare të shtetit, me largu nga puna dhe për t'u mburrur?", ka thënë Haxha. Sipas tij, qeveria duhej të

krenohet me këtë kompani nëse do t'i jepte dividend shtetit. "Duhet të mburresh kur një kompani i jep qeverisë dividend me qindra miliona, kur punëson njerëz dhe kur kualiteti i shërbimit është në nivel. Kjo kompani i ka dhënë mbi 400 milionë euro shtetit të Kosovës dhe ka punësuar mbi 1 200 punëtorë dhe shërbimet kanë qenë më të mirat në rajon në vitin 2009-2011", ka theksuar Haxha.

"Marshojmë për drejtësi" merr mbështetjen edhe të SBASHK-ut

PRISHTINË, 30 MARS - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës do të jetë pjesë e marshit për drejtësi të paralajmëruar nga iniciativa "Liria ka emër" më 2 prill, ditë e diel.

Në njoftimin e SBASHK-ut thuhet se anëtarësia e kësaj sindikate do të marrë pjesë në këtë marsh. "SBASHK-u, në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve, përveç për temat aktuale në arsim dhe në aktivitetet sindikale, ka bashkëbiseduar edhe për kërkesën e shumë kolegeve e kolegëve tanë që nga çerdhjet e deri në universitete për mbështetjen e aktivitetit 'Marshojmë për drejtësi' organizuar nga iniciativa 'Liria ka emër'. Në këtë takim pjesëmarrësit njëzëri kanë vendosur që edhe

SBASHK-u me një numër të konsiderueshëm të anëtarësisë të marrë pjesë në këtë aktivitet", theksohet në njoftimin e SBASHK-ut.

Deri më tani ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike.

Ideatori i platformës "Liria ka emër", Ismail Tasholli, në një intervistë për gazetën "Epoka e re", ka theksuar se ky marsh do të përçojë dy mesazhe: njëri mesazh do të jetë thirrje për drejtësi, tjetri për shprehje të mirënjohjes. Ai ka thënë se është i nevojshëm përbashkimi i shoqërisë sonë rreth disa temave që janë



premissa mbi të cilat janë ndërtuar dinjiteti dhe krenaria jonë kombëtare.

Tasholli ka theksuar se deri më tani në çdo takim që kanë pasur, "Marshi për drejtësi" ka marrë mbështetje

maksimale. "Të gjithë janë të vetëdijshëm për peshën e situatës ku ndodhemi sot dhe e konsiderojnë përkrahjen të nevojshme. Tekefundit, secili e respekton veten kur respekton

periudhën më të ndritur të historisë së re të vendit tonë qoftë edhe nëpërmjet simbolikës së marshit", ka thënë ai.

Tasholli në këtë intervistë ka thënë se UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi, duke theksuar se ish-krerët e saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tyre, nuk janë emra të përveçëm, por janë disa nga emrat e lirisë. "Duhet të jemi shumë të vëmendshëm në kompleksitetin e ngjarjeve që po rrjedhin atje, duke lënë anash hidhërimet politike tipike ballkanike dhe ta dëshmojmë maturinë si veprim të përbashkuar. Mos ta harrojmë, duke mbrojtur ata atje e mbrojmë vetveten, mbrojmë të ardhmen tonë", ka deklaruar Tasholli.

Vitia viziton depon qendrore të vaksinave

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, bashkë me përfaqësues të Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, vizituan depon e re qendrore të vaksinave për Kosovën. Me këtë rast nga afër panë investimin e kompletuar, pajisjet e reja dhe moderne të zinxhirit të ftohtë të cilat shërbejnë për ruajtjen e sigurt të vaksinave.

Ministri Vitia ka theksuar se ky investim me mbështetjen e USAID-it, në vlerë të 1.3 milion dollarëve, ka qenë i një rëndësie thelbësore në periudhën e pandemisë Covid-19 dhe tani do të shërbejë për ruajtjen e



vaksinave në përgjithësi, pasi që shkalla e vaksinimit në Republikën e Kosovës, fatmirësisht, është e lartë krahasuar me shtetet e tjera.

Ky kapacitet i shtuar për ruajtjen e vaksinave do t'u ndihmojë profesionistëve shëndetësorë për shtrirjen efektive të mbulimit të vaksinimit në mënyrë që secili



fëmijë në Kosovë të jetë i mbrojtur nga sëmundjet e parandalueshme me vakcina.

Në këtë depo janë instaluar dhomat e ftohta, dhomat e

ngrirjes, frigoriferët ultra-ngrirës me kapacitet prej 600 litrash, si dhe pjesa e thatë me sipërfaqe prej 575 m2 për magazinimin e artikujve shpenzues.

Szunyog takon Haradinajn, temë diskutimi dialogu Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 30 MARS - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet politike në vend.

Haradinaj ka njoftuar se me të ka diskutuar edhe për dialogun Kosovë - Serbi, obligimet që

duhet t'i kryejnë palët si rezultat i marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve midis dy vendeve.

"Shpreha konsideratën time për angazhimin unik të shteteve anëtare të BE-së për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Po ashtu, pata kënaqësinë ta pranoj vlerësimin e ambasadorit

Szunyog për rolin konstruktiv të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe timin gjatë gjithë këtij procesi. Implementimi i kësaj marrëveshjeje hap një perspektivë më të qartë integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në strukturat euroatlantike", ka thënë Haradinaj.



A mund të ringjallen Telekomi dhe Trepça nga Fondi Sovran?

PRISHTINË, 30 MARS - Ndërmarrjet publike të Kosovës - Telekomi dhe Trepça - dikur motorë të ekonomisë - vështirë se mund të rimëkëmben përmes Fondit Sovran, thotë Berim Ramosaj, ligjërues i lëndëve ekonomike në Universitetin e Prishtinës. "Kam dilema, duke u bazuar edhe në faktin se pronësia publike është burimi kryesor i korrupsionit dhe nepotizmit në ekonominë e Kosovës", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Qeveria e Kosovës ka paraparë që Fondi Sovran t'i marrë nën pronësi të gjitha asetet strategjike të vendit, përfshirë gjigantin metalurgjik Trepça, Telekomin e Kosovës, Korporatën Energjetike të Kosovës, Korporatën e Thëngjillit e të tjera.

Fondi do ta ketë pastaj përgjegjësinë ekskluzive për të investuar në rritjen e vlerës së tyre.

Ramosaj thotë se ndërmarrjet që janë nën pronësi të shtetit operojnë vazhdimisht me afarizëm të dobët. Sipas tij, problemi qëndron edhe në ndërhyrja e politikës në përzgjedhjen e bordeve që i mbikëqyrin ato. "Në bordet e ndërmarrjeve publike zgjidhen zakonisht njerëz joprofesionistë dhe kjo bën që ndërmarrjet të performojnë dobët", thotë Ramosaj. Sipas tij, zgjidhje do të ishte privatizimi. "Për ta rimëkëmbur Telekomin [për shembull] duhen investime të mëdha që mund t'i bëjnë vetëm kompanitë e suksesshme, që kanë kapital të mjaftueshëm dhe udhëheqje të suksesshme", thotë Ramosaj për "Radion Evropa e Lirë".

Histori e gjatë privatizimi

Nga viti 2003 në Kosovë janë privatizuar mijëra asete dhe ndërmarrje shoqërore. Kjo ka ndodhur pasi shumica e tyre pas luftës, më 1999, kanë mbetur pa mirëmbajtje, me teknologji të vjetruar dhe pa investime për një kohë të gjatë.

Procesin e privatizimit e ka nisur Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), ndërsa e ka vazhduar Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Kjo e fundit, aktualisht, është duke krijuar listën e aseteve të cilat do t'i barten Fondit Sovran të Qeverisë së Kosovës. Me themelimin e Fondit Sovran, AKP-ja do të shuhet.

Telekomi i Kosovës operon me humbje

Telekomi i Kosovës është kompani publike, e transformuar në shoqëri aksionare, që pritet t'i kalojë Fondit Sovran. Qeveria e Kosovës është pronare e të gjitha aksioneve të Telekomit. Deri në vitin 2015 kjo ka qenë kompania më fitimprurëse në vend.

Madje, nga viti 2008 deri më 2015, ajo i ka paguar Qeverisë së Kosovës mbi 250 milionë euro dividenda - mjete që ndahen kur kompania shënon rezultate të mira financiare. Por, në vitin 2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, që është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Kosovë, ka gjetur se Telekomi në shtatë vjetët paraprakë ka operuar me humbje. Sipas raportit, humbjet e akumuluar deri më 31 dhjetor 2021 arrijnë vlerën e afro 80 milionë eurove.

Raporti ka gjetur se rënia e performancës ka ndodhur kryesisht për shkak të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimeve.

Humbjet në Trepçë: Mbi 600 mijë euro në muaj

Ngjashëm si Telekomi i Kosovës, edhe gjiganti metalurgjik Trepça ka operuar me humbje në vitet e fundit. Dikur shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës, Trepça, pritet t'i kalojë, po ashtu, Fondit Sovran. Sot është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë të punonjësve të ndërmarrjes. Në raportin e publikuar vitin e kaluar, Zyra e Auditorit ka gjetur se kjo ndërmarrje gjatë periudhës 2019-2021 nuk ka arritur të jetë efikase në shfrytëzimin dhe përpunimin e burimeve minerare. Gjatë kësaj periudhe Trepça ka operuar me



humbje mujore mbi 600 mijë euro, thuhet në raport. Sipas tij, teknologjia dhe infrastruktura e vjetruar kanë pasur rol kyç në performancën e dobët të ndërmarrjes. "Trepça nuk ka arritur t'i krijojë parakushtet e duhura për operim, të cilat do të siguronin shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerare", thuhet në raportin e Zyrës së Auditorit.

Shala: Fondi Sovran nuk ka burime të mjaftueshme financimi

Ish-menaxheri i Trepçës, Ferat Shala, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Trepça nuk duhet të futet në Fondin Sovran. "Sfidat janë të mëdha dhe nuk konsideroj që një fond i tillë mund të ndikojë në afat të shkurtër dhe të mesëm në zhvillimin e saj. Trepça duhet të funksionojë kështu siç është - shoqëri aksionare", thotë Shala,

njëherësh deputet i opozitës në Kuvendin e Kosovës.

Për ta rimëkëmbur Trepçën ai thotë se duhet bërë rivalizimi komplet i ndërmarrjes, teknologjisë dhe resurseve në mënyrë që pastaj të rritet kapaciteti prodhues. "Me kapacitetin e vet që ka Trepça është e pamundur të rivalizohet pa një subvencionim të fuqishëm prej qindra miliona eurosh. Fondi Sovran e ka tërë kapacitetin themeltar 20 milionë euro - që është i pamjaftueshëm", thotë Shala.

Deri ku ka arritur krijimi i Fondit Sovran?

Projektligj për Fondin Sovran aktualisht është në konsultime publike dhe, sipas programit legjislativ të qeverisë, pritet të miratohet brenda këtij viti. Projektligji e definon Fondin Sovran si institucion investues dhe zhvillimor të Kosovës.

Kapitali themeltar i Fondit Sovran është 20 milionë euro dhe mbulohet nga Qeveria e Kosovës.

Për t'u bartur një aset në pronësi të Fondit Sovran, Qeveria e Kosovës ka vënë kusht që ai të jetë i komercializueshëm dhe të premtojë fitim brenda një periudhe të arsyeshme.

Ish-drejtori menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ekrem Hajdari, ka thënë më herët për "Radion Evropa e Lirë" se Projektligji i Fondit Sovran është kualitativ dhe ofron mundësi për zhvillim ekonomik. Megjithatë, burimet e financimit të Fondit Sovran janë të pakta, sipas tij. "Gjëja më e rëndësishme në këtë drejtim mbetet financimi i nevojshëm për funksionalizimin e këtyre aseteve, në dobi të një interesi të dobishëm financiar dhe zhvillimor në vend. Njëzet milionë euro për fillimin e punës së fondit nuk janë të mjaftueshme", ka thënë Hajdari.

Kosova prej vitesh përballlet me probleme ekonomike. Rritja ekonomike vjetore nuk kalon 4 për qind - shifër e pamjaftueshme për ta adresuar problemin e papunësisë që e kalon 20-përqindëshin.

Për më tepër, viti i kaluar është mbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind. Zhvillimi ekonomik, në anën tjetër, ka qenë një ndër prioritetet që ka listuar qeveria aktuale në krye me Albin Kurtin, kur ka marrë detyrën dy vjet më parë. Disa premtime të saj në këtë aspekt janë realizuar, disa të tjera as që kanë nisur.



Koalicioni LV - AAK, valë-valë, veç sa s'ka dalë



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Bisedimet e koalicionit Zajebnicë për Asociacion: Albin Kurti nuk po ia do ta nënshkruajë Marrëveshjen për Normalizim të marrëdhënieve me Serbinë e Aleksandar Vuçiqit, jo se nuk po ka laps dhe se po i dhemb dora e djathtë, por se Vuçiqit i ka humbur lapsi dhe ka artrozë të dorës së djathtë. Madje Albini ka filluar të bëhet nervoz pse nuk po i mundësohet ta nënshkruajë këtë marrëveshje i cili nënshkrim i është bërë obsesion. Nuk i ndezi dy herët e para, mbase e treta do të jetë e vërteta pasi t'i ketë kryer disa punë në ndërkohë. Themelimi i Zajebnicës, tash me një emër tjetër, vetëmenaxhim. Këtë formulë e kishte përdorur edhe Klauzeviqi me thënien e tij të famshme se: "tash lufta vazhdon me mjete të tjera, me mjete politike...". Zajebnicë po, por jo me këtë emër. Prej të gjithë aktorëve politikë, aktivë, gjysmaktivë dhe me potencë politike të rrënuar, i vetmi që, pa asnjë dyshim dhe në çdo çast e përkrahu Kurtin për Zajebnicën, ishte dhe mbeti Ramush Haradinaj, frontmani i AAK-së. Më i bindur për Zajebnicën është Ramushi se vetë Albini. Edhe në takimet që i pati në Amerikë e mbrojti këtë parim në kundërshtim me interesin vital të Kosovës, formimin e Zajebnicës. U betua para Chollet, Blinken dhe Eskobar për besnikëri dhe këtë ia konfirmoi edhe luftëtarit më të vendosur dikur, sot dhe besoj edhe në të ardhmen për autonomi substanciale të Kosovës përmes federatës apo konfederatës asimetrike me Serbinë, ambasadorit Hill i cili nuk po lë gur pa lëvizur për t'ia rikthyer autonominë Kosovës. Po lexoj komente përqeshëse për Ramushin si politikan dhe po habitem me komentuesit që aspak nuk e njohin Ramushin. Ramush Haradinaj është një prej politikanëve më inteligjentë në Kosovë, e ka një inteligjencë të trashëguar dhe të natyrshme sikur që e ka jashtëzakonisht të zhvilluar shqisën e të nuhaturit të mundësisë që i ofrohet dhe që e bën lojtar të pazëvendësueshëm në situata të

caktuara. Prandaj edhe po e luan lojën që po e luan; për asgjë nuk pajtohet me Kurtin, e quan zot shtëpie të një shtëpie me budallenj, njeri të dyshimtë të sigurimit të Serbisë, se ka kimi (ADN) pak serbe dhe cilësime të tjera, aspak afirmative për një kryeministër siç është tani Albin Kurti. Në të njëjtën kohë bënë biseda të fshehta për një koalicion të AAK-së me LV-në, në përpjekje për ta nxjerrë nga loja Vjosa Osmani, presidente aktuale. Duke e ditur se Vjosa Osmani në asnjë mënyrë nuk jep dorëheqje nga "Sellma" dhe "Valdrini" dhe se nuk ka asnjë mënyrë të rregullt gjyqësore për ta shkarkuar nga posti, janë futur në lojë mundësitë e jashtëzakonshme përmes Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Duan të bëjnë "Trininë e Shenjtë" të shkelësve të Kushtetutës, Behgjet Pacolli, Fatmir Sejdiu dhe, tash, Vjosa Osmani. Për ta respektuar barazinë gjinore dhe për t'i respektuar kuotat e përfaqësimit gjinor.

Po pse pikërisht tani ky koalicion: Kosova është në situatë shumë të rëndë politike dhe ekonomike. Çdo gjë, madje edhe ceremonia e syetisë, po kushtëzohet me normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Marrëveshja e Ohrit ia shtrëngon edhe më shumë lakun në fyt Kosovës, ndërsa Serbia nuk ka fare lak. Nëse e lexoni aneksin e marrëveshjes, lehtësisht do ta kuptoni se alfa dhe omega e kësaj marrëveshjeje është themelimi i Asociacionit apo Zajebnicës. Pas themelimit të Zajebnicës, Kosova do ta humbë çdo interesim ndërkombëtar duke e thjeshtësuar çështjen e saj në probleme të brendshme që do të pëllin nga Zajebnica. Fort u gëzuan kur Kurti u përqafua me kryeministrin grek në Prishtinë dhe aso skena intimiteti apo afërsie më ka rënë të shoh vetëm në Lagjen Soho në Londër pas orës 24:00. Menjëherë filluam të bëjmë plane për Greqinë dhe, sipas llogarive tona, ishin vetëm çështje ditësh kur gjyshi grek i Albinut do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Në ndërkohë presidentja e Greqisë na i ftoi morrat me një deklaratë se Greqia nuk ka ndryshuar qëndrim për statusin e Kosovës që, përkthyer në gjuhën e baustellës, do të thotë: "Mallo morgen njohja e pavarësisë së Kosovës..." Greqia mund ta njohë pavarësinë e Kosovës vetëm pasi

Kosova ta përmbushë detyrimin ndaj Marrëveshjes së Ohrit, me Zajebnicën në qendër të qendrës. Të gjithë po flasin vetëm për Zajebnicën, ndërkombëtarë dhe kombëtarë, të parët me emër të viteve 2013 dhe 2015, kurse të dytët duke e kamufluar të njëjtën përmbajtje me një emër tjetër. Albin Kurti po e sjell vazhdimisht një pllakë gramofoni që nuk po e ndërron asnjëherë se kjo Marrëveshje paraqet njohje formale të Kosovës nga Serbia, kurse vartësi i tij permanent, ndryshe i njohur si stërnip i Aristotelit, Platonit dhe Hegelit, jo vetëm sa i përket trashëgimisë së gjakut, por edhe trashëgimisë së veprave filozofike e që te ne njihet si "drvena filozofija - filozofia e drurit apo Pinokio filozofia" e forcoi kryeministrin e lodhur fare duke thënë se në këtë Marrëveshje keni një njohje të fuqishme faktike të Kosovës nga Serbia. Nga aspekti juridik dhe politik është në kundërshtim me çdo normë ndërkombëtare të njohjes, nga aspekti logjik është marrëzi, kurse nga aspekti filozofik edhe mund të shitet, sidomos kur je i rrethuar me intelektualë analfabetë jofunksionalë. Vjosa Osmani kishte hezitime për t'i prerë gjërat duke ia deleguar përgjegjësitë për deklaram një analfabeteje në fushën e diplomacisë që, për fat të keq të saj, por edhe tonin, thuaja që dy vjet mendon se është ministre për Punë të Jashtme, pa diasporë.

Albin Kurti ka guxim të nënshkruajë çdo marrëveshje pa asnjë hezitim. Madje është shumë këmbëngulës ta bëjë këtë. Mirëpo, qartazi Albinut i mungojnë resurset anatomike dhe fiziologjike t'i zbatojë marrëveshjet e nënshkruara e që thjeshtësohen në dy: themelimin e Zajebnicës dhe formalizimin e Kishës Ortodokse të Serbisë në Kosovë. Për këtë i duhet një njeri me k..e, një njeri me muskuj apo ana e fortë (e dhunshme) e anës së butë (të qullët). I forti është Ramush Haradinaj, i qullëti është Albin Kurti. Këtë e kanë të qartë edhe ndërkombëtarët. Atyre, në këto çaste nuk iu duhet një politikan me parime dhe kombëtar por iu duhet një njeri me k..e të mëdha që ua shtynë para zbatimin e Marrëveshjes. Aktualisht në Kosovë, këtë punë të krahut (zbatimin e aneksit të marrëveshjes) mund ta bënë vetëm Ramushi. Prandaj po bëhet lojtar i fortë sepse njeri i lig nuk mund të përdoret për situata

të forta. Albini ka rënë nga fiku vendimmarrës, ka mbetur vetëm si përfaqësues institucional dhe arsyetues i një dështimi dhe mashtrimi të madh. Ramush Haradinaj, në këtë moment është alter ego i stupcit që do të vendosë për zbatim të aneksit të marrëveshjes. Prandaj edhe është i pranuar nga ndërkombëtarët kurse LVV e merr si zgjedhje të zorit, si ogiç pas të cilit do të shkojnë dhe ndjehen të sigurt deri sa t'i përfundojnë këto punët që nuk kryhen pa pasur koç... të mëdha. Edhe për të keq. Kryesisht për të keq! Opozitarizmi i PDK-së dhe LDK-së është sikur loja e Kosovës ndaj Andorrës. Për të ardhur keq, në kuptimin më të butë. Në rethanat e krijuara, Vjosa Osmani, thuaja pa parti dhe pa asnjë ndikim politik, po bëhet e tepërt dhe e panevojshme. Kapaciteti i saj për implementim të aneksit marrëveshjeje së Ohrit është i barabartë me zero kontribut. Paraqet pengesë prandaj e ka humbur krejtësisht peshën specifike politike. E hasmuar thuaja me të gjithë, selektive ndaj luftëtarëve të UÇK-së, deri vonë hije totale e Albin Kurtit, nuk i duhet më askujt. Unë nuk pajtohem me mënyrën si duan ta eliminojnë por..., por edhe kjo ka vepruar në të njëjtën mënyrë ndaj të gjithëve që nuk janë pajtuar me te. Në mënyrë sadiste është sjell me pengjet në Gjykatën Speciale në Hagë, meritoret kryesorë që u ul në karrigen e presidentes. I ka shërbyer, deri në nënshtrim LVV-së dhe Albin Kurtit prandaj do ta paguaj një çmim. Është paradoksale por e vetmja dritë në fund të tunelit ku është katandisur Vjosa Osmani dhe Lista Guxo, ka qenë dhe mbetet një Pec. Haxhi Qamilit nuk po i gjendet adresa askund!

Çka fiton Kosova nga ky koalicion i mundshëm: Kosova definitivisht fiton në planin e përgjithshëm: "të trashët e Surles". Individualisht Albin Kurti e mban pushtetin pa shtet, Ramushi mund të bëhet president, nëse bëhet. Ndërkombëtarët fitojnë sepse e kanë një politikan (Albini) që pranon çdo gjë që kërkohet nga ai (nënshkrimet) dhe një president muskolor, karizmatik dhe që nuk ia ndien se çka ndodhë në Bangladesh, Ramush Haradinajn. Albin Kurti e siguron një rrufepritës nga rrufetë që do t'i vijë nga partia e vet dhe eventualisht nga opozita e vijagruar. Albini ka rënë në

kurthin që e ka ngritë vet për të tjerët prandaj një telefonatë nga Chollet, siç ishte ajo në Kuvendin e Kosovës ia zgjatë qëndrimin në pushtet dhe këtu edhe qëndron mjerimi i një Albini, dikur idealist, tash i zënë në bakllavanë e pushtetit. Një lugë, qoftë edhe helm nga Chollet, Blinken, Eskobar, Rahman Morina i Katalonjës Joseph Borrell dhe rrenci bredhës, Miroslav Lajçak paraqet eliksir për Albin Kurtin dhe kabinetin e tij jo - qeveritar kur gara bëhet se cili ministër është ma katastrofal se tjetri dhe asgjë tjetër. Nga "trojka" e politikanëve që iu kam besuar më së shumti, Baca Adem Demaçi sigurisht është në Parajsë i larguar nga Ferri i quajtur Kosovë, Kadri Veseli po mbahet peng në Gjykatën Raciste Speciale të Hagës kurse Albin Kurti, i veshur me pallton e Grofit Minhauzen, ky hyrë në Rugën e Golgotës, për ta kryqëzuar në fund, o nga të tijët, o nga të huajt! Ramush Haradinajn e ka xhoker për Zajebnicën kurse proserbin Dritan Abazović e ka xhoker për formalizimin e Kishës Ortodokse të Serbisë në Kosovë. Këtë test poshtërsie Abazović me shumë sukses e ka kryer në Mal të Zi duke e rikthyer Kishën ortodokse serbe në pushte. I ka mbetur edhe një punë e pistë për ta bërë; ta pamundësojë rizgjedhjen e Millo Gjukanoviçit si president i një Mali të Zi të pavarur dhe ta mundësojë zgjedhjen e kandidatit të Listës Serbe për Malin e Zi, president i Malit të Zi, si protektorat i Serbisë.

Të presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas së cilës do ta kuptojmë nëse Lumi Vjosa do pëlçet nga fuqia apo do të shndërrohet në një llucë që do të përfundojë në lumin Ibër. Afër vendit të lindjes! Kthimi në bazë! Për mua mbetet edhe një shpresë, ardhja e Çlirimtarëve sikur që erdhën në zgjedhjet e fundit. Unë besoj se kanë ardhur ta çlirojnë veriun e Kosovës, ata kishin ardhur ta çlirojnë Kosovën nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe udhëheqësit e saj e që e kuptoj si një kontribut i Çlirimtarëve për Gjykatën Raciste Speciale në Hagë. Tash janë konsoliduar besoj me Zonë Operative në Shtime dhe me Komandantin e Përgjithshëm të Çlirimtarëve me seli në Shtime. Për qëllimin që e kanë pasur vend më të mirë se Shtimja nuk mund ta gjejnë si në aspektin e logistikës politike, po ashtu edhe në planin ushtarak. Shtimja i arsyetohet për çdo gjë!

Musmurati: Po i dërgojmë në Hagë letrat dhe vizatimet e fëmijëve të Prishtinës për ushtarët e UÇK-së

Drejtoresha e Arsimit në komunën e Prishtinës, Besianë Musmurati, ka bërë me dije se ka mbledhur disa punime të nxënësve të shkollave të Prishtinës, letra dhe vizatime, të cilat i kanë shkruar pasi disa ish-ushtarë të UÇK-së kanë mbajtur disa ligjërata në shkollat e Prishtinës.

Musmurati ka thënë se disa prej tyre do t'i dërgojnë në Hagë, në qendrën e paraburgimit, aty ku po mbahen padrejtësisht ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa e Pjetër Shala.

Njoftimi i plotë i Musmuratit:

Po i dërgojmë në Hagë letrat dhe vizatimet e fëmijëve të Prishtinës për ushtarët e UÇK-së.

Pas ligjëratave të ushtarëve të UÇK-së në disa prej shkollave të



Prishtinës, fëmijët bënë punime të ndryshme që i shpërndamë në OVL të UÇK-së. Disa prej tyre po i dërgojmë tek liderët e UÇK-së që po mbahen në Hagë.

"Mrekullive të botës duhet ti shtohet edhe lufta çlirimtare e UÇK-së" shkruan Leka nga shkolla Naim Frashëri.

"Unë ende kam besim te njerëzimi sepse ende kam besim tek ju. Na keni treguar herë pas here se ne mund t'ju besojmë. Andaj, ju jeni heronjtë tanë!" thotë Erza, e cila ka lindur në vitin që është shpallë Pavarësia.

"Ndoshta sot je me thinja, por ne do të kujtojmë gjithmonë për zgjuarsinë, trimërinë dhe sakrificën që e ke bërë për fëmijët e Kosovës" thotë letra tjetër.

Shpresojmë që me këto letra do të mund të përçojmë mirënjohjen e thellë që e kemi për UÇK-në dhe vlerat e saj.





I dashur ushtar i UÇK-së,
 Dua të falenderoj nga zemra që në kohën më të vështirë për vendin tonë ke shku në luftë me mbrojtur Kosovën.
 Unë jam shumë e vogël dhe nuk kam përjetu luftën, por e di që ka qenë tepër kohë e vështirë. Shumë fëmijë janë dëbuar nga Kosova edhe shkollat janë mbyllë. Por, kanë qenë ushtarët e UÇK-së që kanë luftu me Serbinë dhe i kanë mbrojtë fëmijët e Kosovës.
 Liria që ne e gëzojmë sot në Kosovë është meritë e juaja personale. Prandaj, ju falenderoj që keni qenë të guximshëm me çliru vendin tonë.
 Shpresoj që edhe gjenerata jonë kanë me qenë të guximshëm si ju dhe kemi me përmirësu edhe më shumë vendin tonë.
 Me shumë dashuri, Nita Gashi SHFMU "Meta Bajraktari"


I dashur ushtar i UÇK-së
 Ndalojta sot je me thirrja, por me do të kujtojmë gjithmonë për sguarimin, trimërinë dhe sakrificën që e ke bërë për fëmijët e Kosovës. Ka qenë shumë të nevojshet edhe nuk e dijmë se si ka qenë lufta, sepse ju kemi guacu për neve.
 Edhe pse nuk e kemi përjetu luftën me e kujtojmë guacimin dhe sakrificën tënde dhe të shokëve e shqerëve tua. Shpresojmë që një ditë me ju loz brenar me juse, ashtu siç na bëni brenar ju neve.
 Urime Ditën e shpirtit të Pavarësisë e ushtari trim!
 Të duam përgjithmonë,
 Ulëra Gërguri
 "Faqe Honica"
 VI/6

I dashur ushtar,
 Urime Ditën e Pavarësisë - 17 shkurti! Unë jam Guri Bekaj nënës më shkollën "Elena Gjika" në Prishtinë. Kam vendosë me shkru këto letër me një falenderim që në kohën më të vështirë për Kosovën ju keni luftu me na mbrojtë.
 Unë e di që gjatë luftës jeni vëra shumë gjyshër, fëmijë e mësues. Kjo është tepër e tmerrshme, por fal juve me sot jetojmë të lumtur në Kosovë. Prandaj për nder të pavarësisë, ju falnderoj shumë sikurse dhe ju falenderoj më shumë të fëmijëve të Prishtinës.
 Jeni inspirimi joni që edhe me me qenë si ju edhe me mbrojtë vendin tonë.
 LIRIA KA EMËR
 Guri Bekaj
 SHFMU: Elena Gjika

I dashur luftëtar, veteran i UÇK-së
 Unë sot po shijoj ditën që na e solle të më sakrificën tënde.
 Më vërtetë e tua, të shokëve të tu si vendosën themelët e shtetit të Kosovës.
 Mrekullive të botës duhet të shtohet edhe lufta e UÇK-së. Historia, trimëritë e prindërve, na mposhtën se tmeria juaj ishte e parashikuar në historinë mjekësore. Ju nuk luftuat me një ushtar, ju luftuat me dashuri, ju luftuat me arrësuar.
 Ndajhu kërenar përherë, sepse atë qëfarë jeni të për kombin tënde nuk ka për tu haruar, sa të këto shqiptarë mbi tokë.
 dashuri për UÇK-on!
 Lekë Beza
 SHFMU: Naim Frashëri

Përkëndetje Ushtar!
 Unë që po të shkruaj jam një adoleshente nënës e shkollës Elena Gjika. Unë mendon time kam shumë pyetje për të bërë dhe shpresoj t'i shpreh me qartësi në këtë letër.
 O ushtar i vendit tim, i Kosovës që ruajtës martirë, a e fshih të vërtetë ndonjë me mendim kur u nis me luftë dhe e mbajtë veten kur në lottet më sytë e sytë? A mendon se ky do të ishte pengafimi i saj i fundit?
 O ushtar trim ku e gjetë atë forcë të madhe për të luftuar? A kishte ndonjëherë frikë në fushabotë apo nuk mendon asnjë kur plumbat fluturonin përpara shpirtit tënd me metet e ftohtë të dimrit të këto sytë pyetje të dendura, ngarkuar me armë e me këmbët e lagura nga uji që të frynte me hepuet e shpuara? A ta ndonjëherë mendon idetë dhe dëshirën për ta parë vendin tënd të lirë? A të jepte kurajo atë forcë kjo idetë?
 Kam dhe një pyetje të vërtetë e ushtar. E kam bledhur gjat me mendon time. Si je mbytur kur ke humbur shokët e tu në fushabotë? A të kanë rrjedhur lotët lagur, por e kujtojmë apo ke shtrënguar nëballat nga dhimbja? Sab e vërtetë kjo pyetjeje andaj të keshq ndaj se të futo me emocione, por me!

I dashur ushtar i UÇK-së
 -Falenderimet që na ke mundësuar që fëmijët e Kosovës me jetu me liri. Gjigju me ka treguar se sa shumë keni luftu me kushte tepër të vështira, pa ushqim e pa teshia të nevojshme që na me qenë të lirë.
 Për shkak që ju kemi guacu me luftu vramësin që me i shpëtë fëmijët e Kosovës, me do të ju falenderojmë përgjithmonë. Gjithashtu me edhe e gjithë klasa ime e kemi ullenë bekimin e ushtarit (sikurse ju) që kemi me mbrojtë Kosovë edhe kemi me qenë mjek, inxhinierë, arkitektë... të rinjë të guximshëm sikurse ju.
 Falenderimet që i ke mbrojtë fëmijët e Kosovës të kemi shembull!
 Me dashuri
 Lerola Hyseni
 Shkollë Fillore "Naim Frashëri"
 UÇK



Fjalët e fundit të shkrimtarëve të mëdhenj para vdekjes

Shkrimtarë të njohur të botës së letrave, para vdekjes së tyre kanë thënë fjalët e fundit: prekëse, mesazhe, himne, fatkeqësi, zhgënjim... atë çfarë jeta dhe bota e tyre e brendshme shpirtërore ka grumbulluar për t'u shprehur në frymën e fundit.

GJERGJ FISHTA

Shkrimtari i madh shqiptar i "Lahutës së Malcisë" vdiq më 30 dhjetor të vitit 1940 në spitalin civil të Shkodrës. Revista "MAPO" botoi para disa vitesh detaje të rëndësishme të ditëve të fundit të jetës së tij. Në studimin e Fr. Agustin Gemelli, shkruhet: "At Gjergj Fishta, pak para se të ndahej nga kjo jetë, pasi u la porosi rinisë françeskanë të provincës shqiptare, e mbyllte testamentin e tij me këto fjalë: "Po vdes i kënaqur, sepse kam punuar për fe, për Atdhe e për provincën tonë".

Ndërkohë, sipas At Viktor Volajt, bashkëpunëtor i afërt i poetit, Gjergj Fishta para se të vdiste kishte përmendur nevojën për rishikimin e "Lahutës së Malcisë" dhe kishte përsëritur fjalën "i kryqëzumi" në latinisht. Ai kishte kërkuar t'i pikturonin në murin përballë shtatit të tij skena nga "Gjyqi i fundit".

Edhe Patër Marin Sirdani, filolog e mik i poetit, shkruan në librin e përgatitur nga Benedikt Dema, se Fishta e mbyllti testamentin e vetë me këto fjalë: "Po des kondën (i kënaqur) përse kam punue për fe, Atdhe e për provincën tonë".

Ndërkohë, Lasgush Poradeci shkruante se mesazhi i fundit i poetit Gjergj Fishta janë fjalët e tij thënë një françeskani që i qëndronte te koka në çastet e fundit: "Po vdes. Ju tash kenë me mendue për salikim, por edhe kombi ka të drejtë për rreth meje". Ndërsa, italianii Enriko Grasi, që e kishte njohur nga afër poetin, duke folur për popullaritetin e tij në të gjitha shtresat e popullsisë, pohon se prej një të riu shkodran kishte dëgjuar se fjalët e fundit të shenjta të Fishtës kishin qenë: "Jo për tjetër, por sepse po lë armikun mbi truallin shqiptar, mua më vjen keq që më duhet të vdes".

FAIK KONICA

Për shqiptarin më të veçantë në historinë tonë, edhe vdekja ashtu duhet të ishte. Nuk e prishi rregullin Faik Konica në momentet e fundit të jetës së vetë. Është e shkruar nga studiuesi i njohur i tij, Nasho Jorgaqi, që një ditë më parë se t'i ndahej shpirti nga trupi, Konicës iu dogj kafeja në dhomën e tij. Dhoma iu mbush me tym dhe u deshën ca minuta të mira të vendosjes normaliteti.

"Nuk më duket shenjë e mirë kjo", mësohet t'i ketë thënë Nolit. Por, çudia nuk mbaroi këtu. Hëngri drekë të rëndë, një bërthollë shumë të madhe dhe kur mbaroi tha: "Nuk do ha mish për tri ditë". Por, në mbremje ai vdiq nga një atak në zemër.

Megjithatë, historia e fjalëve të fundit apo testamentit që ka lënë Konica nuk mbaroi këtu. Deri më sot ekzistojnë dokumente dhe

dëshmi që Konica të ketë lënë një testament, sipas të cilit nuk do ta treste dheu nëse nuk do ta varrosnin në atdhe. Këtë e ka përforcuar Fan Noli, i cili në disa letra dërguar Enver Hoxhës i ankohej se Faikun e kishte në "dollap", domethënë në morg dhe shteti shqiptar duhet të financonte varrimin në atdhe. Por, Enveri e kishte shpallur armik me kohë Konicën dhe nuk e bëri këtë. Mbështetur në këtë dëshmi, në vitin 1995, eshtrat e Konicës rivanosen në Shqipëri në kodrat e Liqenit Artificial të Tiranës. Mendohet se testamenti i është lënë Sejfulla Malëshovës dhe kjo është përmendur, por për hir të vërtetës, testamenti origjinal i tij nuk është botuar asnjëherë.

FAN NOLI

Një nga figurat më të mëdha të historisë së Shqipërisë, Fan Noli, u nda nga jeta në moshën 83-vjeçare në Fort Lauderdale, Floridë, larg vendit të cilit i kushtoi jetën e tij. Më 13 mars të vitit 1965, në ditën e fundit të jetës, Noli kishte në dorë një libër me poezi të poetit francez, Alfred Devini (Afred de Vigny) dhe po lexonte poemën "Vdekja e ujkut". Sipas studiuesit dhe shkrimtarit Nasho Jorgaqi, Noli dha frymë në kopshtin e shtëpisë ku po lexonte poemën. Libri i Devinit i kishte rënë nga dora dhe ai kishte nënvizuar këto vargje: "Rënkimi, vaji dhe lutjet janë të gjitha dobësi! Detyrën bëj si burrë pa u epur kursesi! Në rrugën vetë fati që deshi të caktojë! Pastaj si unë, vuaj dhe vdis pa hapur gojë".

Të gjithë studiuesit që janë marrë me fundin e jetës së Nolit, imbahjnë si testament këto vargje të cilat nënvizoi Noli. Sipas Nolit, njeriu duhet të përballë në këtë mënyrë me vdekjen. Të vuante, të vdiste pa hapur gojë, gjë të cilën e dëshmoi edhe vetë në fundin e tij.

LASGUSH PORADECI

"Shtërgu i fundit" iku nga kjo jetë në orën 3 pasdite të 12 nëntorit të vitit 1987. Një nga lirikët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare, që i dhuroi Shqipërisë "Vallen e yjeve", "Yllin e Zemrës", e më tej bëri të flasin shqip "Eugen Onjegin" i Pushkin, lirikat e Lermontovit, poemat e Hajnes, të Majakovskit e Miskievicit, lirikat e Gëtes dhe poezi të Lanaut, Brehtit, Hygoit, Mysës, Bajronit, Shellit, Bërnsit, të Emineskut, etj., u la në harrës dhe në mjerim të plotë pas vitit 1944. I diplomuari në Grac të Austrisë, ishte një përkthyes me normë, që po vdiste dalëngadalë nga indiferentizmi i shtetit. I ballafaquar çdo ditë me rrezikun e ndonjë internimi të mundshëm që kishte kapur shumë shokë të tij të letrave, ai stërmundohej për gjëra nga më të voglat.

Një jetë e vështirë që e kaloi në shtëpinë e tij me lagështirë, të papërfunduar, në Tiranë, e pjesërisht në shtëpinë e rrënuar të tij në Pogradec, i solli edhe sëmundjen që e çoi drejt vdekjes. "Kostandinë, bijë e babait, trupin tim edhe të vdekur ta shpesh në

Pogradec", i thotë ai vajzës së tij të dashur që i qëndron tek koka. Pasi heshti pak e pyet: "Po a ke lekë ti, bijë e babkës, të më varrosësh mua atje?". Këto janë fjalët e fundit të poetit të madh shqiptar që vdiq padrejtësisht si i vogël.

PETRO MARKO

"Cila do të ishte fjala e fundit kur do të jepja shpirt? Tani mendoj si i gjallë dhe do të dëshiroja të isha i gjallë deri në çastin e fundit kur të thosha: Jetova kohën si një aktor që nuk e shprehu mirë pjesën e caktuar nga regjisorit jetë..."; shkruan në një nga shënimet e tij të pabotuara më parë, gjeniu i Brezit të Humbur. Kjo është fjala e fundit që kishte dëshirë të thoshte ai. Një "Hasta la vista" vetëm prej Petro Markoje. E menduar deri në detaj dhe e trishtë, si subjektet e romaneve të tij. Apo ashtu si jeta e tij, që ishte e vetmja vepër e pashprehur mirë. Dhe kjo, jo për faj të tij. Një nga shkrimtarët më të vuajtur gjatë regjimit diktatorial, i mbylli sytë në dhjetor të vitit 1991, atëherë kur sapo po hapeshin perdet e një Shqipërie të lirë.

TEODOR KEKO

Dhe, në fjalët e fundit Teodor Keko do bënte letërsi. "Në këtë botë nuk ka njerëz të përjetshëm, por kalimtarë. Është e vështirë ta pranosh vdekjen tënde, por ja që ajo është prezente dhe një ditë vjen, dhe atëherë pavdekësinë, pikërisht atë që lakmojmë, na e dhuron nëse e meritojmë ajo vdekje. Filozofi e komplikuat apo jo!", këto ishin fjalët që shkrimtari njohur kishte thënë pak kohë para se të vdiste.

I lindur më 2 shtator 1958, në një familje të shquar kineastësh, Teodor Keko që i vogël shquhet për humorin e hollë dhe shpirtin e rebeluar, cilësi këto që do të ridimensionoheshin me kalimin e viteve. Në vitin 1979, në moshën 19-vjeçare boton të parat poezi në gazetën letrare "Drita", përcjellë me mjaft dashuri nga personaliteti i letrave shqipe Fatmir Gjata. Shkrimtari i njohur është shumë aktiv gjatë lëvizjeve demokratike në Shqipëri dhe zgjidhet deputet i Partisë Demokratike për dy mandate rresht. Në vitin 1996, i zhgënjyer largohet përfundimisht nga politika e drejtpërdrejtë dhe vendos të kontribuojë në demokratizimin e jetës si intelektual përmes fjalës në shtypin e shkruar. Pas një sëmundjeje të rëndë, Teodor Keko vdes më 20 gusht 2002 nga një sëmundje e rëndë.

DHIMITËR SHUTERIQI

Shkrimtari i madh Dhimitër Shuteriqi lindi dhe vdiq ditën e hënë. Jetoj në tri periudha: mbretërinë, socializmin dhe demokracinë. Ai mbi të gjitha i ka dhënë letërsisë kombëtare duke shkruar dhe historinë e saj. Por, edhe më mbresëlënëse janë momentet e fundit të jetës së vetë. Bashkëshortja e tij, Myneveri, tregon se në një moment kur po i rrinin tek koka e gjithë familja, ai u shpreh se "ç'bukuri ish, që aty ishin

të gjithë". Por, edhe më kuptimplotë se kjo, ishte ajo që tha shumë më gjerë dhe me brengë. "Ti, Myneveri, e di si e kam shkruar historinë e letërsisë, me një brengë për tërë jetën", një fjali që nënkupton se shumë poetë dhe shkrimtarë që nuk iu lejuan t'i përmendte në atë libër, do të mbetet një brengë që do ta merrte me vete në var. Por, në të njëjtën kohë edhe një thirrje për letrarët shkrimtarë e historianët për të shkruar një vepër të plotë dhe të saktë të letërsisë. Për të gjitha këto, Dhimitër Shuteriqi punoi tërë jetën. Por, nuk arriti që të plotësonte atë që mbante thellë në vete. Megjithatë, ato fjalë jo vetëm për familjen, por edhe për të gjithë mbeten si një këshillë e thënë me zë të ulët në vesh.

NONDA BULKA

Chri-Chri i mbylli sytë në orën 20:10 të mbremjes së datës 14 nëntor të vitit 1972. Prej kohësh ishte i sëmurë prej kancerit. Ai e dinte se ishte nisur në një rrugë pa kthim, por nuk e lëshonte veten. "Do ta mund demonin", kujton ish-bashkëshortja e tij, Qefseri, fjalët që përmendte shpesh shkrimtari që prej vitesh kishte pushtuar zemrat e njerëzve.

Ai është një ndër shkrimtarët e parë të viteve '30 që me krijimet e tij solli kritikën e protestën e hapur kundër regjimit të Zogut, demaskimin e shoqërisë së prapambetur feudale, një qëndrim të prerë antiklerikal, si dhe denoncimin e politikës imperialiste të kohës, motive këto që më pas u trajtuan pothuaj nga të gjithë autorët e rinj të viteve '30 e sidomos nga Migjeni.

Megjithatë, sëmundja e rëndë shpeshherë ia ulte moralin. Në një letër dërguar miqve të tij, kur shkron të kurohet në Bukuresht, shkruan: "Të dashur shokë, Sterjo, Zisa, Fate! L'inevitable, l'inexorable, l'ineluctable, l'irreparable... erdhi (e paevitueshmitja, e papërthyeshmitja, e pariparueshmitja...). Po hyj edhe unë në listën e kandidatëve të 50000-ve që i venë pikë librit të jetës, çdo ditë në turmën e miliardave frymorëve që mbërthen globi". Me tej, duke e mbyllur letrën, thotë: "PS.: Në hyrje të spitalit me shkronja të padukshme, po që duken është shkruar 'Voi ch'entrate, Lasciate ogi speranza' (Ju që hyni, braktisni çdo shpresë)! Jo Dante, po K... (kanceri)".

VIRGINIA WOOLF

Një prej shkrimtareve më të rëndësishme të shekullit të kaluar, e cila ka revolucionarizuar letërsinë. Fjalët e fundit: Jam e sigurt se po çmendem sërish. Besoj se nuk mund të kalojmë sërish nëpër ato kohë të tmerrshme. Dhe kësaj radhe nuk do e rimarr veten. Kam nisur të dëgjoj zëra.

ANTON CHEKHOV

Anton Çehov, në shtratin e vdekjes kërkoj morfinë dhe shampanjë.

"Ka kaluar shumë kohë që kur kam pirë shampanjë për herë të fundit", ishin fjalët e fundit që tha.

VOLTAIRE

"Tani, miku im, nuk është koha e përshtatshme për të bërë armiq", ishin këto fjalët e fundit të Volterit, thënë priftit që i kërkoj të hiqte dorë nga Satanai.

FRANZ KAFKA

"Më vrit, ndryshe je vrasës", janë fjalët e fundit të Kafkës që i drejttoheshin mjekut të tij, i cili nuk donte t'i bënte një mbindozë vdekjeprurëse morfine. Kafka vuante nga tuberkulozi dhe nuk mund të fliste ditët e fundit të jetës.

ALDOUS HUXLEY

Aldous Huxley, autori i librit të mirënjohur "Më e mira e botëve", para se të vdiste, i kërkoj së shoqes t'i jepte një dozë LSD – një lloj droge e njohur për efektet psikologjike – në mënyrë që të ikte nga kjo botë në gjendjen mendore që dëshironte vetë.

JOHANN WOLFGANG VON GOETHE

Fjalët e fundit të Gëtes ishin: "Më shumë dritë"! Natën para se të vdiste, shkrimtari i njohur gjerman kishte diskutuar me nusën e djalit për fenomenin optik.

JANE AUSTEN

Jane Austen, e pyetur nga e motra se çfarë dëshironte pak para fundit, thotë: "Nuk dua asgjë përveçse të vdes".

JAMES MATTHEW BARRIE

"Nuk mund të fle"! Para se të vdiste, Barrie i dha spitalit të Londrës të drejtat e kryeveprës së tij, "Piter Pan". Ky spital vazhdon edhe sot e kësaj ditë të përfitojë nga trashëgimia.

HUNTER S. THOMPSON

Hunter S. Thompson, para se të vriste veten shkroi në letër: "Qetësohu, nuk do të dhembë".

EDGAR ALLAN POE

"Zot, ndihmoje shpirtin tim të shkretë!", ishin fjalët e fundit të Edgar Allan Poe. Vdekja e tij ishte e mistershme dhe ende nuk ka të dhëna se çfarë i ndodhi në ditët e fundit të jetës.

LEV TOLSTOI

Tolstoi në fund të jetës e braktisi shtëpinë dhe u mundua të jetonte mes njerëzve. Fjalët e fundit para se të ndërronte jetë: "Dua shumë gjëra, i dua të gjithë njerëzit".

EMILY DICKINSON

"Duhet të shkoj, megjulla po shtohet", ishin fjalët e fundit të saj, që kishte zënë shtratin për shtatë muaj para se të ndërronte jetë.

EUGENE O'NEILL

"E dija! I lindur në një dhomë hoteli dhe si për dreq po vdes në një dhomë hoteli". O'Neill vdiq nga pneumonia, pasi kishte vuajtur edhe nga Parkinsoni, çka e kishte bërë të paafte për të shkruar për vite të tëra.

AJAZ EMINI - Ditar (VI)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Po, sepse kishin ndihmën e kolegëve të mijë ushtarak të cilët veçese kishin dalë në lëndinën përballë edhe po i udhëzonin vendin e sakë se ku duhej bërë aterimin këta dy helikopterë "Black Hawk" të Armatës Amerikane. Pas lëshimit të helikopterëve në livadh, pritëm derisa u hap dera e helikopterit, e pastaj u afruam 10-15 metra edhe i pritëm derisa erdhën Gjenerali me Kolonelin!

Takimin e bëmë në lëndinën para ndërtesës tonë, aty ku ishim unë, Gjenerali Lama, Kapiteni Wiggis dhe pjestarët e tjerë të grupit tonë, kurse nga helikopteri erdhën Gjenerali Hendrix, Koloneli Hannes përkthyesja shqiptaro-amerikane e tyre Sebahate që e thirrnin Sebi (ishte një vajzë me prejardhje nga Mali i Zi po e lindur në Nju Jork të SHBA's, me të cilën kishim ardhur në Shqipëri së bashku që nga fillimi) si dhe pilotët ushtarak të helikopterëve. Pas arritjes në objektin tonë dhe njoftimit të tyre me Gjeneralin Lama, ata së pari shprehën dëshirën që të hyjnë mbrenda objektit tonë, sa për të na parë edhe vendqëndrimin tonë se ku po punonim dhe jetonim gjatë kësaj kohe.

Hyrën mbrenda edhe e vizituan dhomën tonë të punës si dhe dhomën e gjumit.

Gjithashtu u interesuan edhe për kushtet tona aty, si dhe na pyetën se a kishim nevojë për ndonjë send që po na mungonte, e që herën tjetër do të na sillnin këtu.

Prej aty, me makinat ushtarake që kishim që të gjithë përveçese pilotëve të helikopterëve shkua në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Shqipërisë të Divizionit të Kukësit në zyrën e Komandantit Gjeneralit Kudusi Lama.

Në hyrje të zyrës së Gjeneralit Lama, u ndamë në dy grupe. Në njërin grup ishte: Gjenerali Hendrix me Gjeneralin Lama dhe përkthyesja Shqiptaro- Amerikane Sebi, kurse në grupin tjetër ishim: Koloneli Hannes, Kapiteni Wiggis, Shefi i Intelgjencës së Ushtrisë së Shqipërisë Shyqyri Shabani me një bashkë- punues tjetër shqiptarë dhe unë përkthyes i tyre.

Takimet zgjatën më tepër se një orë, dhe tema kryesore e bisedës ishte se ku gjenden sa më saktësisht pozicionet e pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe distanca e tyre nga forcat e armikut paramilitaro ushtarako policore serbe, si dhe pozicionet e të gjitha palëve.

Gjithëashtu u bisedua edhe për prioritetet, se cilët pozicione të armikut duhej sulmuar sa më parë nga aviacioni i NATO-së.

Gjatë këtij takimi u vendos se më me prioritet do të ishte për sulmin kundër armikut serb, që së pari të bombardohen pozicionet e tyre për rreth kufirit Kosovë-Shqipëri, me qëllim që të bëhet hapja e koridorit të Junikut, e që t'i bëhej edhe më i lehtë furnizimi i forcave të UÇK-së me armë dhe materialet tjera që kishin nevojë prej këndeje kufirit.

Pas këtij takimit përsëri u kthyem



20 Qershor 2000, Sojevë /Kosovë, Ajaz Emini me Gjeneralin e UCK's Agim Cekun

në vendqëndrimin tonë, që nuk ishte aç largë, ku edhe ishin në pritje që të dy pilotët me helikopterët e tyre ushtarak: njëri për Gjeneralin Hendrix dhe tjetri për Kolonelin Hannes.

Meqenëse kishin parë prej së largu aterimin e helikopterëve ushtarak amerikan në oborrin tonë, tani kur ne po ktheheshim atje lartë, afër banesës që kishim, atje pamë një numër të madh të mbledhur gazetarësh dhe fotoreporterësh të cilët kishin arritë para neve dhe po na pritnin kur të ktheheshim për të marrë ndonjë informatë apo shkrepjen e ndonjë foto të Gjeneralëve me Kolonelin!

Mirëpo në të arritur neve para banesës, u ndëgjua piskama e Gjeneralit Lama ndaj gazetarëve, dhe më pas edhe ndihma e disa pjesëtarëve të Policisë Ushtarake e Shqipërisë që ishin në të njëjtën ndërtesë e që kishin dalë për të parë se ç'po ndodhte. I dëboi që të gjithë gazetarët dhe fotoreporterët që po na pritnin nga rrethi ku ishim!

Arsyeja e dëbimit të gazetarëve ishte më tepër për shkak të sigurisë së personelit të lartë ushtarak amerikan, si dhe marrëveshja jonë me Forcat e Shqipërisë, që grupi ynë të mos kishte kurrëfarë takimi me to. Qëllimi kryesorë ishte i sigurisë, por edhe që të mos të çfaqeshim në ballinat e gazetave të ndryshme të botës haptas si dorë e djathtë e UÇK-së.

Aty në oborr qëndruam krejt afër, për derisa hypën në helikopterët e tyre Gjenerali Hendrix me Kolonelin Hannes dhe u ngritën në ajër, për t'u kthyer përsëri secili në punën e vet në Shtabin e Ushtrisë Amerikane në Rinas (e që quhej Shtabi i Tiranës).

Gjatë mbrëmjes, aty rreth orës 17:00 patëm përsëri takimin tjetër të radhës me Gjeneralin Kudusi Lama, me të cilin biseduam në lidhje se si vijoi vizita dhe takimi i sotëm me liderët e Armatës Amerikane në Shqipëri, si dhe na dha edhe shumë materiale me

objektivat më të rinjë që sapo kishin arritur në lidhje me lëvizjet dhe vendëndodhjen e forcave të armikut serb. Ai na ofroi informata edhe më të sakta, e me koordinata, që sulmet e aviacionit të NATO-së të jenë sa më të shumëta dhe më precize!

Në takimin e sotëm Gjeneralit Lama ia dhamë edhe hartën më të re të Kosovës, si dhe rajonit kufitarë me Shqipërinë, që sapo na e sollën para gjysëm ore me një helikopter tjetër nga Shtabi i Armatës Amerikane në Rinas. Helikopteri kishte ardhur special vetëm e vetëm për të sjellë hartat e reja, shumë më të sakta për punën tonë të përbashkët!

Sipas mendimit tim, po mendoja se ndoshta kjo ishte edhe harta më e shtrenjtë që kishim pasë ndonjëherë, por edhe më e vlefshme sepse dihen harxhimet e helikopterit. Vetëm starti i fluturimit të një helikopteri kushton \$2000, plus fluturimi nga Rinas rreth një orë e gjysëm!

Gjithashtu qëllimi kryesorë i kësaj harte ishte që të jemi që të gjithë në të njëjtat koordinata që përdorshin nga grupi vëzhgues i UÇK-së dhe Forcat Aleate të NATO-së, sepse gjerë më tani ishin me disa ndryshime në shtrirjen e koordinatave (katrorëve /grids) në hartat e Jugosllavisë. Ndoshta edhe ky mundë të ishte shkak që kishin ndodhur disa aksidente gjatë bombardimeve të aviacionit të NATO- së mbi refugjatët tonë shqiptarë, si dhe bombardimet e gabuara mbi pozicionet e UÇK-së (ky është mendimi im personal)...

Pas dorëzimit të hartave të reja, përsëri filluam me punën në verifikimin e pozicioneve më të reja të armikut serb, si dhe që të shpejtojmë që sa më shpeshë të ketë sulme mbi forcat të gjakpirëse serb.

Për derisa unë me Kapitenin Wiggis po bënim përcaktimin dhe koordinimin e objektivave të reja nga hartat serbe në ato amerikane,

të cilat harta tani po përdorshin edhe nga pilotët e aviacionit të NATO-së, aty para nesh në zyre arriti përsëri Gjeneral Lama me një ushtar tjetër, për të cilin menjëherë e kuptova se ai nuk ishte nga Forcat e Ushtrisë së Shqipërisë, sepse pikë së pari ai kishte dialekt kosovar. Gjithashtu edhe nga pamja më dukej si person i njohur prej më herët mua! Me të afruar Gjeneral Lama na tha: "Tani po ju prezentoj me njërin që iu premtova para disa ditësh! Edhe i thua Kapitenit Wiggis të mos ketë frikë, se askush nuk e dinë për këtë takim!". Pasi se ne, Njësia e Forcave Speciale Amerikane kishim urdhëra nga Shtabi i Përgjithshëm Amerikan por edhe nga ai i NATO-së që edhe pse bashkëpunonim për informacionet e UÇK-së, ne nuk guxojmë të kemi lidhje apo takime direkte me pjesëtarët e UÇK-së, për shkak të marrëveshjes politike të palëve në teren. Po, sepse UÇK-ja nuk ishte e pranuar si forcë ushtarake nga amerikanët, NATO'ja, apo OKB'ja, pasi se edhe Kosova ende nuk ishte shtet i pavarur. M'u për këtë, duhej bashkëpunuar me UÇK-n, pra neve na duhej gjithmonë një ndërmjetësues i Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë. Për këtë e kishim ndërmjetësin tonë të përhershëm Gjeneralin Kudusi Lama të Shqipërisë!

Pas prezentimit të tij nga Gjenerali Lama, kuptuam se ky person ishte njëri nga personalitetet e krerit të Shtabit të UÇK-së Bislmi (Zyrapi), për të cilin para disa ditësh Gjenerali na informoi se do të vinte në vizitë këtu në Kukës te zyrja e tij. Gjatë kësaj bisede të shkurtër me të, u bisedua rreth punës që ne po bënim prej këtu, si dhe dihmën që po i drejtonim luftës së Kosovës, gjithkund ku kishte nevojë! Gjithashtu biseduam se tani e tutje, ne që të dy palët e Shtabit Amerikan si dhe atij të Shtabit të Shqipërisë, do të përdornim të njëjtën hartë topografike sikurse

edhe Shtabi i UÇK-së që e kishte po të njëjtën hartë. Kështu puna jonë do të lehtësohej si edhe do të jetë shumë më efikase dhe më e saktë për sulmet e ardhëshme që do të ndërmerren nga aviacioni i NATO-së, si dhe t'i shmangeshim në maksimum gabimeve kartografike, që ndoshta edhe ishin shkak i gabimeve të më hershme të bombardimeve mbi forcat tona shqiptare në Kosovë. Pas një kohe të shkurtër disa minutësh, Gjenerali Lama me mikun e tij nga UÇK-ja dolën nga dhoma ku ishim, me qëllim për të na lënë të qetë dhe më të lirë, që të kryejmë detyrën tonë që kishim përpara nesh. Neve sa më shpejtë duhej kryer punën, sepse tani veçese koha kishte ikur dhe ishte ora 22:00 e mbrëmjes. Pasi se të shkonim në zyrën tonë të punës, përsëri na duhej që këto informata të objektivave të rinjë përmendëherë t'ia përcjellim Komandës Amerikane në Rinas (Tiranë), për sulmet e ardhëshme të bombarduesve të NATO-së mbi forcat kriminale serbe.

Në zyrën tonë mbërritëm rreth orës 22:30 para mesnate, aty ku përsëri vazhduam detyrën dhe punën tonë para se t'ia transmetonim ato informata Komandës Ushtarake në Rinas, nëpërmjet të radio- lidhjeve tona ushtarake që kishim.

Përderisa e përfundova përkthimin e listës dhe verifikimin me koordinatat e kësaj dite, tani veçese ora kishte kaluar 2:30 pas mesnate, ku tani veçese filloi dita e re!

Derisa po nxirrja pikat strategjike për sulmin e ardhshëm të aviacionit të NATO's, aty në krye të listës pashë se në fillim po shkruante data e 25 majit të ditës së martë, ku disi i habitur dhe i humbur në punë, m'u kujtua se sot kjo ditë ishte edhe ditëlindja ime.

Nga puna që patëm sot, paskam harruar krejtësisht se sot ishte edhe ditëlindja ime, (25 maji). Këtë ditë që gjithëmonë e gjithë familja ime organizonim në mënyrë më festive, që të ma bëjnë sa më madhështore këtë ditë. Por, përsëri po e them se sot më bëri edhe më të kënaqur sukcesi i punës që bëmë gjatë tërë kësaj dite madhështore!

Meqenëse kolegët tjerë që ishin me ne veçese ia kishin futë gjumit, e njoftova vetëmse Kapitenin

Wiggis me të cilin ende po punonim se sot kisha edhe ditëlindjen. Ai disi me habi përmendëherë mu drejtua me zë të lartë sikur të më bënte fajtorë mua:

"Pse nuk na tregove asnjërit se sot ke ditëlindjen"? Unë iu përgjigja: "Edhe unë vetë e paskam harruar se në çfarë date jemi sot nga puna që patëm. Nuk mu kujtua se është 25 maji. Kapiteni Wiggis me të shpejtë nxorri nga një birrë nga thesari i pijeve tona, sepse pije tjera nuk kishim për të festuar përpos ujit dhe disa birrave që kishim blerë herën e fundit kur ishim në qytet. Iu luta që mos ta bëjë të madhe që t'i zgjojë tani

edhe 5 kolegët, pjesëtarët tanë për të festuar, të cilët tani veçese ishin në gjumë, apo ndoshta edhe në ëndërrat më të mira të tyre. Mirëpo nga zhurma e kapitenit, njëri prej tyre na ndëgjoi kur po cakronim shishet e birrës për shëndet në ditëlindjen time. Ai u zgjua, gjë që edhe i zgjoi që të gjithë shokët tjerë të cilët edhe ata së bashku për gjumshëm morën nga një birrë edhe më kënduan dhe më uruan ditëlindjen!!! Urata më e madhe për mua, ishte puna që po kryenim së bashku si edhe rezultatet e së cilës tani veçese kishin fillu të shifen qartazi. Po, pasi se tani edhe kryesia serbe veçese ishte gati që të dorëzohej, për shkak të bombardimeve të shumëta dhe aq të sakta të NATO-së që po bëheshin mbi forcat e tyre paramilitaro- ushtarako-policore serbe.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Meqenëse koha ishte e mirë edhe sulmet e NATO-së u rritën në 537 fluturime, ku ata sulmuan: 15 pozicione të artilerisë, 6 pozicione mortajash, 5 tanke, 1 lancues raketash tokë-ajër si dhe objektiva të tjerë ushtarak. Në 24 orët e fundit pati 650 fluturime të aviacionit të NATO-së nga të cilët u sulmua villa e Presidenciale në Dobanovci për të dytën natë e cila kishte komandën operuese në bunker. U sulmuan transmetuesit dhe riletet e radio dhe TV's në: Beograd, Sterple, Palist, Pirot dhe Sremski Karlovc, gjithashtu sulmet vazhduan edhe në kazermat ushtarake në: Shabac, Pejë, Novi Pazar dhe Pirot, depot e municionit në: Prishtinë, Novi Pazar dhe Kurshumli, depot e karburantëve në: Leskovc, Bord dhe Prahovo.

Gjatë ditës së sotme, në orën 10:45 para dite u njohëm edhe për dy sulme tjera të aviacionit të NATO-së në afërsi të Vitisë dhe Gjilanit si dhe bombardimi në radio-transmetuesin televiziv afër Kaçanikut, pastaj sulmi në afërsi të Rahovecit. U raportua se ishte sulmuar edhe në Gjylekarë dhe Budrigë e epërme. Në orën 23:30 të mbrëmjes u qëllua edhe qendra logjistike në Ralja dhe Sopot të Beogradit. Bombardimi pati edhe në fshatin Begaljica dhe në afërsi të Bubanj Potok. U sulmuan magazinat në: Prishtinë dhe Titovo Uzhice, sulme pati edhe në komandën e mbrojtjes ajrore në Novi Sad, në postin komandues në Prishtinë, objektin ushtarak ushtarak në Kraljevë, në bazën ndihmëse në Krivovo, në tunelin hekurudhor në Prishtinë i cili po përdorej si magazinë ushtarake si dhe depon e Policisë Speciale MUP në Beograd. Moti për sot nuk ishte shumë i volitshëm, por gjithësesi sulmet e NATO-së vazhduan edhe u qëllua më së shumti në pikat më të larta të regjimit komandues të Millosheviqit si Villa e Presidentit në Dobanovci e cila kishte edhe bunkerin komandues, Ministrinë e Punëve të Mbrodëshme, qendrën e operacioneve të mbrojtjes ajrore në Rakovicë, largpërçuesin e rrymës elektrike në afërsi të Beogradit, radio riletin në Uzhice dhe Sremski Karlovc. Sulmet tjera u bënë edhe në

aeroportin e Sjenicës, mbi radarin në Novi Sad si dhe depon e municionit në Verdnik.

Në orën 22:45 të mbrëmjes sulmohet në efërsi të Vitisë në Kosovë si dhe në jug të Gjilanit. Në orën 8:30 të mëngjesit u sulmua në afërsi të fshatit Ralja i cili ishte një post i logjistikës serbe në jug të Beogradit.

Gjatë ditës së sotme u bombarduan edhe kazermat ushtarake në mbrendësi të Serbisë, në Shabac e cila ishte bombarduar dhe më herët, më 11 maj dhe 18 maj.

E mërkurë 26 maj 1999

Siç po shifej që tani, gjatë ditës së sotme nuk do të kemi aq ditë të nxanun siç e patëm ditën e djeshme. Para dite ia mësyem pazarit të qytetit të Kukësit për të blerë ca gjëra, për të cilat kishim nevojë. Gjatë tregëtimit në pazare Kapiteni Wiggis na bleu nga një maicë e që ishte souvenir për ne me logon e UÇK-së, na bleu për të gjithë pjesëtarët e grupit Njësisë të Forcave Speciale që ishim në Kukës, si dhe bleu flamurin e UÇK-së për në zyrën e tyre në Boblingen të Gjermanisë atje ku kishin Shtabin Qendrorë të tyre "THE HOME OF EUROPE'S BEST" (Shtëpinë e më të Mirëve të Evropës)! Gjatë tregëtimit të mëtutjeshëm në pazar, blemë edhe një antenë satelitore për televizor që të mund të përcillnim edhe radio-televizionet tjera botërore. Pastaj vazhduam me blerjen e dërrasave për riparimin e banjës që kishim si dhe ndarjen e koridorit nga të burgosurit ushtarak në Policinë Ushtarake të Shqipërisë në anën tjetër, si dhe mbulimin e murit përballë. Meqenëse të gjithë kolegët e mijë të grupit patën shprehë dëshirën qysh herët që të kemi disa suvenire edhe nga pjesëtarët e UÇK-së, si flamurin apo edhe stemat e UÇK-së, për çka edhe i porosita disa herë pjesëtarët e UÇK-së. I porosita ata që vinin gati thuajse çdo ditë në oborrin tonë, në depon e armëve dhe municionit përballë që kishim në oborrin tonë për t'i furnizuar aradhat luftarake të tyre me armët që i kishin aty. Por nuk e dijë se pse nuk na i sollën! Gjatë bredhjes tonë nëpër qytet, kapiteni Wiggis më pyeti se a mundë që të shkojmë në shtabin e UÇK-së i cili nuk ishte shumë largë prej pazarit edhe t'i kërkojmë suveniret direkt prej shtabit të tyre! Unë për vete nuk e dija se Shtabi i UÇK-së gjindej aty afër, të cilën gjë e bëmë. Kishte qenë vetëmse disa minuta prej vendit ku ishim, në afërsi të qendrës së qytetit. Me arrijten tonë para shtabit, ushtarët e rojes së UÇK-së disi u habitën kur na panë neve përballë tyre me dy Hamvee's makina ushtarake amerikane. Mirëpo, për mos t'i sjellë hutë apo ndonjë shqetësim atyre, menjëherë i sqarova arsyen pse ne kishim shkuar aty. Njëri prej tyre me të shpejtë hyri mbrenda dhe u kthye brenda vetëmse disa minutash me një pjesëtarë tjetër të tyre, dhe më tha se për momentin nuk kishin amblemat e tyre aty. Ai na premtoi se do të na i sjellnin në zyrën tonë, të cilin premtim edhe e mbajtën, ku pas disa ditësh na i sollën në banesën tonë nja 10 copa të ndryshme të stemave të UÇK-



23 Nëntor 1999, Sojevë /Kosovë, Shahadija me Sekretaren e SHBA's Madeleine Albright në Kampin Ushtarak Amerikan "Bondsteel", Sojevë

së, të cilat i shpërndava secilit pjesëtarë dhe të tjerat i mbajta për vete. Këta i ruaj me shumë nostalgji...

Në qytet takuam shumë njerëz por edhe një të rijë nga rrethi i Prizrenit, i cili na tregoi se gjatë largimit të tij me refugjatët tjerë shqiptarë të Kosovës, ishte nxerrë nga kolona e tyre nga kriminelët serb. Ai kishte qenë edhe me anëtarët tjerë të familjes, dhe së bashku atë me shumë meshkuj të tjerë shqiptarë i kishin ndarë edhe i kishin rrafë dhe maltretu. Pastaj i kishin dërgu në një lloj burgu (kamp përqëndrimi) diku në Kosovë, e që më vonë me ndihmën e Kryqit të Kuq ky dhe me të tjerët ishin liruar dhe ishin sjellë këtu në Kukës të Shqipërisë! Nga pamja e parë e tij, ai shifej se ishte tepër i lodhur dhe dobësuar, që më tepër i përngjante atyre fytyrave boshnjake të Srebrenicës që i kishim parë në television sikurëse në videot dhe fotot nga kampet në Bosne-Hercegovinë! Ai na tregoi se kishin përjetuar maltretime dhe tortura të paimagjinuara nga çetnikët serb. Na rrëfeu se si armiku serb ia kishte vrarë edhe njërin nga të afërmit e familjes së tij para syve të tyre, duke i akuzuar këta se ju jeni pjesëtarë të UÇK-së, dhe duhet vrarë dhe likuiduar që të gjithë. Po gjatë kësajë dite edhe Presidenti Serb, Slobodan Millosheviq u akuzua për krimet në Kosovë, po me të njejtat akuza siç ishin akuzuar më herët edhe Mlladiqi dhe Karaxhiqi në Bosne dhe Hercegovinë! Pas kësajë akuze nga ndërkombëtarët tani edhe Millosheviqi duhej të përgjigjet njëjtë si kriminelët e lartpërmendur serb, për krime kundër njerëzimit në Gjyaktën Ndërkombëtare të Hagës. Edhe ky ishte një lajm gëzimi, se më në fund po duket se drejtësia po ngadhënjon... GËZUAR!

Pas kthimit në zyrën tonë, aty rreth orës 13:30 më arriti një shkresë direkte nga Gjeneral Lama për lëvizjet më të reja të trupave

paramilitaro-ushtarako- policore të armikut serb, si dhe të autoblivave dhe tankeve të tyre në afërsi të kufirit të Shqipërisë. Me të marrë këtë shkresë menjëherë e fillova përkthimin, pastaj bëra verifikimin e koordinatave të këtyre pikave strategjike. Qëllimisht që të jenë të gatshme sa më parë për t'i dorëzuar zinxhirit komandues për bombardim nga aviacioni i NATO's, të cilat vetëm pas disa minutash ia dorëzova kapitenit Wiggis të gatshme i cili mbrenda një kohe krejtë të shkurtër nëpërmjet radio lidhjeve ia transmetoi Shtabit Amerikan në Rinas (Tiranë) për urdhërin e bombardimeve të këtyre caqeve nga aviacioni NATO-së mbrenda orëve të ardhëshme. Në orën 19:00 të mbrëmjes, na erdhi lajmi nga Shtabi Amerikan në Rinas se aviacioni i NATO-së nga pala amerikane veçese sapo kthehej prej bombardimit të suksesshëm mbi forcat e armikut serb. Nga kjo punë e jona e më herëshme, ata kishin goditur dy tanke dhe dy autoblivat që ishin zënë në lëvizje gjatë asajë kohe, si dhe kishin vrarë mëse 12 ushtarë të forcave paramilitaro ushtarako policore serbe. Ky ishte akcion i drejtuar nga njësia jonë e Forcave Speciale të Armatës Amerikane të stacionuar këtu në Kukës, si dhe me informacionin e njësisë vëzhguese të UÇK-së dhe ndihmës së ndërmjetsuesit tonë Gjeneralit Kudusi Lama. Pas marrjes së këtijë lajmi, që të gjithë u gëzuan pa masë dhe menjëherë unë dhe Kapiteni Wiggis shkuam në zyrën e Gjeneralit Lama për ta njoftuar për këtë aksion shumë të suksesshëm. Gjithashtu shkuam edhe për t'i kërkuar edhe caqet më të reja të armikut serb që kishte, për t'ia bërë gati për sulmet e ardhëshme aviacionit të NATO-së. Me të mbërrirë në derë të zyrës, menjëherë i treguam këtë lajm të mirë Gjeneralit Lama i cili u gëzua pa masë, dhe na tha: "E shifni se sa mirë është kur shofim rezultatet e suksesit të punës që po bëjmë, dhe

do të punojmë për sa më tepër suksese".

Gjatë kësajë dite edhe aradhat e UÇK-së kishin përparuar me akcionet e tyre në shumë pika të operacionit për zgjerimin e territorit të tyre të lirë në Kosovë. Këto lajme të mira na i dha edhe vetë Gjeneral Lama, i cili pak më herët sa ishte njoftuar nga Shtabi Qendror Ushtarak i UÇK's, prej mbrenda Kosovës nga vetë Gjenerali Agim Çeku. Për këtë sukses të bombardimeve të NATO's ishte edhe puna jonë me ndërmjetësimin e Gjeneralit Amerikan John Hendrix, Kolonelit Hannes si dhe Gjeneralit të Ushtirës së Shqipërisë Kudusi Lama si dhe ndihma nga grupi vëzhgues i Gjeneralit të UÇK-së Agim Çekut. Gjatë kësajë kohe sa ishim edhe ne në zyrën e Gjeneralit Lama, nga Njësia Vëzhguese e UÇK-së na arriti edhe shkresa më e re me pozicionet edhe më të reja të forcave të armikut serb. Kjo punë zgjati deri në orën 22:00 të mbrëmjes, prej ku u kthyem në zyrën tonë të shoqëruar nga truproja e Gjeneralit Lama për shkaqe sigurie të errësirës sepse duhej bërë një rrugë këmbësorësh rreth dy kilometrash në këmbë. Pas arrijtes në vendqëndrimin tonë, përsëri vazhdova me përkthimin dhe verifikimin e pikave më të reja, për t'i bërë gati për sulmin e radhës, dhe me to mbaruam në orën 24:00 të mesnatës. Pastaj pa kurrëfarë vonese bëmë verifikimin e koordinatave dhe Kapiteni Wiggis ia përcolli Shtabit Amerikan në Rinas (Tiranë) dhe nga Rinasia ia përcjelli Komandës Supreme me Gjeneralin Wesley Clark për t'i urdhëruar bombardimet e radhës, dhe kështu vazhdonte puna zinxhirë Kosovë-Kukës- Rinas- Bruksel-Kosovë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sipas informacioneve të sotme, kuptuam se sot ishte vala më e madhe e operacioneve të

bombardimeve të aviacionit të NATO-së që nga fillimi i bombardimeve të 24 Marsit 1999. Mbrenda 24 orëve të fundit, kishim mbi 640 fluturime të aviacionit të NATO-së dhe mëse 280 objektiva të qëlluara në forcat ushtarake policore serbe, si dhe të pozicioneve tjera duke qëlluar edhe bazat raketore dhe radio-lidhjet e armikut serb. Aviacioni i NATO-së sot kishte qëlluar edhe në: rrethin e Prishtinës, Aeroportin e Sllatinës prej ku ishin ndërgju 13 shpërthime të mëdha raketash. U qëlluan edhe objekte dhe pozicionet e ushtrisë serbe edhe në Prizren, Lipjan dhe Bujanoc. Gjatë kësaj dite pati edhe shumë bombardime prej NATO-së edhe mbrenda në Serbi si në Leskoc, Nish, Bor, Uzhice si dhe në Beograd. Sot përsëri u qëllua vila e Presidentit serb Slobodan Milosheviqit.

E enjte 27 maj 1999

Siç po shifet edhe kjo ditë po na kalon me shumë gjëra interesante. Para dite ishim në pazarin e Kukësit ku blemë edhe disa gjëra që po na duheshin. Për herë të parë vendosëm që të drekojmë jashta ambientit tonë, në një restorant modest mu aty afër pazarit të Kukësit! Në të njëjtën godinë ku ishte restoranti ishte edhe një shitore e teknikës së bardhë ku u njoftuam edhe me pronarin e restorantit që ishte në derën tjetër, i cili ishte edhe pronar i kësaj shitore të teknikës së bardhë.

Aty ngjitas ku ne po blenim disa gjëra për të cilat kishim nevojë, si shenjë faleminderimi që blemë aty dhe për punën që po bëjmë në ndihmë të Kosovës, ai na ftoi që të provojmë dhe ushqimin në restorantin e tij!

Pasi blemë gjërat që na duheshin ne kaluam në restorant, u ulëm rreth një tavoline edhe porositem nga një birrë dhe morëm me vete nga një qofte me sallatë të cilat kishin qenë të përgaditura shumë mire. Ishin jashtëzakonisht të mira dhe me shije, por edhe me pamje të mrekullueshme. Pasi i pimë birrat, morëm ushqimin dhe iu faleminderuam pronarit të restorantit dhe ikëm për në banesë. Posa u kthyem në vendqëndrimin tonë na erdhi porosia urgjente nga Shtabi Qendror i Armatës Amerikane në Rinas për verifikimin sa më të shpejtë të objektivave të reja që kishim marrë për t'i bërë gati për bombardimet e aviacionit të NATO-së që duhej të fillonin në orën 20:00 të mbrëmjes. Ata ishin në kërkim të caqeve të reja. Pas marrjes së kësaj kërkese me porosi urgjente prej shtabit, menjëherë e lajmërova Gjeneralin Lama për kërkesën që na erdhi! Edhe Gjenerali menjëherë e pranoi kërkesën me plot dëshirë që të takoheshim sa më shpejtë që është e mundur edhe pse ai ishte në një mbledhje me të tjerët. Unë dhe Kapiteni Wiggis shkuam me vrap për në zyrën e tij atje ku u gjetëm vetëmse mbrenda disa minutash në Shtabin e Ushtrisë së Shqipërisë. Atje në zyrën e të cilit ku u konsultuam për shumë gjëra, ai na tregoi që dy objektiva nga nëntë të tjerë që i kishim, të mos

sulmoheshin sepse tani sa ishte njoftu se ato pika sapo i kishte marrë UÇK-ja në duart e veta. Edhe një cak tjetër e anulua sepse aty UÇK-ja ishte shumë afër në distancë vetëmse 600-700 metra në pozicione largë forcave të armikut serb.

Gjatë kësaj kohe morëm edhe disa informata të reja për pozicionet e fituara nga UÇK-ja, si dhe për pozicionet tjera serbe që tani ishin krejtë afër aty, dhe pastaj me të shpejtë u larguam për në zyrën tonë.

Saktë, në orën 20:00 mbërritëm në zyrën tonë dhe përmënjëherë, pa kurrëfarë vonese kapiteni ia transmetoi me radio-lidhjet që kishim objektivat më të reja Shtabit Amerikan në Rinas që pastaj ata të vazhdojnë punën e tyre zinxhir për në sulmin bombardues.

Rreth orës 22:00 të mbrëmjes, nëpërmjet të radio-lidhjeve ushtarake ndërgjuam se veçse kishte filluar ekzekutimin nga ajri i këtyre objektivave (të caqeve serbe). Ndërgjuam për caqet që po ndërmerreshin dhe ishin në shënjestër dhe gati për tu qëlluar nga piloti Amerikan. E për këtë ishte bërë një gabim i madh, sepse siç po shihej, dikush në lidhje nuk e paskan anuluar objektivët 3 dhe 4 që i kishim anulë më herët. Këto objektiva tani ishin gati në shënjestër për t'i qëlluar, ishin objektivat e gabuara për të cilin më herët Gjenerali Lama na tha që mos të qëllohen. Most ë qëllohen sepse tani ato pika sulmi ishin në duart e UÇK-së Nga kjo radio-lidhje që ndërgjuam që të gjithë u shqetësua pa masë dhe tani duhej intervenuar në mënyrë urgjente direkt me pilotin që mos të gjuaj! Në grupin tonë që kishim njëri nga pjesëtarët tanë që ishte me profesion nga Forcat Ajrore të Armatës Amerikane që quhej Joe (Xhoi) e që ai kishte mundësinë për ndërhyrje direkte me aviacionin bombardues të NATO-së. Ai menjëherë telefonoi shtabin qendrorë prej ku bëheshin konfirmimet me aeroplanët bombardues në ajër, të cilëve ia sqaroi problemin e caqeve 3 dhe 4 dhe pastaj ai vetë e lajmëroi edhe pilotin që ishte në ajër që të stoponte bombardimin e pikave të

lartëpërmendura dhe mos të sulmoheshin në asnjë mënyrë këto pika! Ato ndoshta ishin edhe sekondat e fundit para se piloti ti shkrepse raketat e sulmit, ky aksion i yni kurseu jetërat e shumë pjesëtarëve të UÇK-së dhe pas stopimit të këtij gabimi që të gjithë së bashku e festuam suksesin e shpëtimit të jetërave të shumë luftëtarëve të UÇK-së. E festuam me ngritjen e dollisë me nga një birrë që kishim. Edhe pse ne ia kishim dhënë më herët informatat e sakta se çka duhej sulmuar, diku largë nesh ishte bërë një gabim që nuk falet kursesi, sepse dikush nuk i kishte larguar nga lista caqet 3 dhe 4, e që ne i kishim kërkuar të anulohen menjëherë pasi se na informoi Gjenerali KudusiLama!

Shumicën e bombarduesve të NATO-së që fluturonin mbi hapsirën ajrore të Shqipërisë, zakonisht vijën ajrore të fluturimit e kishin mbi neve në Kukës. Gjithashtu edhe në bazë të radio-lidhjeve ne ishim në gjendje që shumicën prej tyre t'i ndërgojmë, por edhe t'i shifnim me sytë tanë lartë në qiell para se të hynin mbi zonën ajrore të Kosovës për të ekzekutuar caqet e caktuara të armikut serb. Para ardhjes së bombarduesve të NATO-së në zonën tonë, ne ngjiteshim lartë mbi objektin tonë ku po qëndronim në pullazin i cili ishte i rrafshët dhe aty ku kishim bërë një tavolinë druri dhe karrika për rreth. Para se të fillonin bombardimet merrnim nga një birrë në dorë edhe i pritnim atje lartë me plot gëzim, sepse ishte një punë të cilën edhe ne ishim pjesëmarrës, dhe tani duhej festuar me dolli suksesin tonë!

Gjatë kësaj kohe u informuam se që të gjitha objektivat që i kishim dhënë më herët ishin ekzekutuar me shumë sukses. Gjithashtu na u konfirmuan sukseset e caqeve të një nate më herët, ku ishte edhe një nga caqet më kryesore, edhe ai i Koshares, atje ku po zhvilloheshin luftimet e rrepta në mes të forcave të UÇK-së kundër armikut serb.

Për këto sulme të NATO-së në orën 24:30 na informoi edhe Shtabi Amerikan nga Rinas, ne lajmëruam menjëherë edhe

Gjeneralin Kudusi Lama i cili po na priste për këto rezultate të sulmit. Gjatë bisedës me Gjeneralin Lama ndërgjova nga vetë ai se ishte tepër i gëzuar dhe tani ndihej i rahatuar për këto suksese. Në fund të bisedës na dëshiroi një natë të mirë dhe të rahatshme, edhe na ftoi që të nesërmen ta shoqëronim atë në manovrat që po mbaheshin me municion të gjallë nga Ushtria e Shqipërisë. Ato manovra do të mbaheshin diku në afërsi në mes Kukësit dhe Morinës, afër kufirit Kosovar ku do të mirrmin pjesë edhe z. Rexhep Mejdani President i Shqipërisë, z. Pandeli Majko Kryeminister i Shqipërisë, z. Luan Hajdaraga Minister i Mbrojtjes së Shqipërisë dhe shumë të tjerë.

Kjo manovër ishte më tepër edhe si kundërpërgjigje ndaj forcave të armikut serb, të cilat disa herë kishin sulmuar dhe hyrë edhe në mbrendësi të kufirit të Shqipërisë ku kishin sulmuar disa fshatra e edhe kishte pasë civilë shqipëtarë të vrarë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Numri i sulmeve të NATO-së gjatë 24 orëve të fundit arriti në 741 fluturime, nga të cilat u sulmuar forcat Serbe në Kosovë, ku të cilave iu shkatërruan: 10 pozicionet e artilerisë, 8 autoblinda, më së pakti 5 tanke, 4 copa artilerisë kundërajrore, disa pozicione mortajash, 2 Antonov Colt transportues të lehtë aeroplanësh, 1 lancues transporter raketash tokë-ajër, 1 radar dhe disa automjete ushtarake.

Në orën 13:25 qëllohet ura në afërsi të Lesvkocit kurse në orën 16:30 qëllohet stacioni meteorologjik në Palic afër Suboticës të Vojvodinës. Caqet tjera që u sulmuar janë edhe: Depot e municionit në Kurshumli, Prishtinë, Novi Pazar dhe Boljevac. U sulmuar edhe riletet transmetues të radio TV-së në: Kerstac, Kaçanik, Stara Pazova dhe Ruma, prej logjistikës së depove të municionit në: Kragujevc, Titovo Uzhice, Prishtinë, Çuprija dhe Rajla, depot e karburanteve në: Kraljevc, Sjenicë dhe Batajnica, aeroportet në: Prishtinë, Ponikve,

Batajnicë, Oberva dhe Nish. U qëllua edhe kazerna e shtabit të policisë speciale në Kula Milicija, posti i komandës së logjistikës në Livadica edhe ura në autostradën në Rashkë.

Sot më herët në Shtabin Qendrorë të NATO-së në mes të Anglisë, Gjermanisë, Francës dhe Italisë ishte biseduar edhe për opcionin e ndërhyrjes me forcat e këmbësorisë në Kosovë, mirëpo gjerë më tani nuk ishte dhënë kurrëfarë detali për shtyp në lidhje me të.

E premte 28 maj 1999

Pasi se u zgjuam, rreth orës 8:00 të këtij mëngjesi të bukur pranveror, filluam përgaditjet tona që të shkonim në ftesën e Gjeneralit Kudusi Lama për të parë manovrën e gjallë ushtarake të Shqipërisë që do të zhvillohej sot. Në orën 10:00 para dite u nisëm për në vendin ku do të zhvillohej manovra ushtarake që të gjithë së bashku, përveçse njëri nga grupi që mbeti në zyrën tonë kujdestare. Në poligonin e manovrës ushtarake shkuam si zakonisht me dy Hamvee, në shoqërinë e një shefi të policisë ushtarake të Shqipërisë. Rreth orës 10:30 arritëm tek vendi i ngjarjes, që ndodhej krejtësisht në afërsi të pikës kufitare të Morinës, e që na ndanin vetëmse disa kilometra nga kufiri Shqipëri-Kosovë. Në të arritur aty, neve të Njësisë Speciale Amerikane menjëherë na u drejtuan për filmime shumë kamera dhe gazetarë televiziv që ndodheshin aty, mirëpo meqenëse ne ishim të këshilluar nga shtabi ynë që t'i shmangemi gjithëqysh mediave në përgjithësi, me një mjeshtri Kapiteni Wiggis na tërhoqi tërë grupin tonë nga prezenca e mediave dhe u larguam prapa rreshtave të mysafirëve që ishin present aty. Qëllimi ishte që mos të kemi ndonjë publikim në mediat botërore se si ushtarët Amerikan hapas po përkrahin dhe bashkëpunojnë me ushtrinë e Republikës së Shqipërisë!

Në orën 10:45 para dite arritëm Presidenti Mejdani me VIP-at e tjerë në përcjelljen e trupërojeve të tyre. Pas aritjes së tij, ata bënë përhëndetjet e tyre nën ceremonitë tjera ushtarake të shoqëruara edhe nga Gjenerali Kudusi Lama. Gjenerali Lama erdhi na përhëndeti grupin tonë edhe na ofroi që të uleshim në rreshtin e parë afër tyre, afër Presidentit Mejdani, mirëpo për shkak të mediave dhe publicitetit, Kapiteni Wiggis nuk pranoi që të uleshim në rreshtin e parë por u larguam pakë anash që mos të jemi në qendër të vëmendjes së mediave të ndryshme që ishin present.

Pas fillimit të manovrës aty përballë neve në lëndinën poshtë po dukej sikurse po zhvillohej një lloj beteje me tanke dhe me armë të ndryshme zjarri. Gjatë manovrës ushtarake u bënë gjuajtjet e ndryshme armësh si gjuajtjet nga topat të kalibrave të ndryshëm, minahedhësit, tanke, pushkomi-tralez dhe më në fund me kaqusha (lancuesve raketore). Kjo manovër ushtarake me municion të gjallë kishte qëllimin dhe karakterin edhe për t'i treguar



17 Qershor 1999 Sojevc /Kosovë, në këtë shtëpi kaluam natën e parë në Kosovën e Lirë me të njëjtën Njësi Speciale Amerikane nga Kukësi në Shqipëri.

armikut kriminel serb andej kufirit, se Sheti i Republikës së Shqipërisë ende kishte ushtarët dhe armatimin për t'iu kundërvu çfarëdo force dhe rreziku që do të vinte nga kushdo qoftë, po edhe nga pala e armikut serb.

Për këtë manovër ushtarake që po zhvillohej kishte patur shumë reagime, edhe nga pala e NATO-së me këtë lloj akti. NATO-ja nuk ishte e kënaqur sepse mendonin se po bëhen provokime të pa nevojshme për konflikt më të gjërë dhe direkt me Serbinë, për çka iu kishte lutë Shqipërisë që mos ta zhvillojë këtë manovër, nga friga që Serbia mos do të provokojë, që edhe Shqipëria direkt do të zhytej në këtë konflikt. Arsyja e mospranimit të propozimit të NATO-së nga Shqipëria që ta anulojë apo ta shtyjë manovrën ushtarake për më vonë, ishte sepse forcat serbe kishin sulmu disa herë në mbrendësi të kufirit të Shqipërisë. Pas mbarimit të manovrës, ne u kthyem në vend qëndrimin tonë ku edhe u relaksuam secili sipas dëshirës së vetë.

Dikur gjatë mbrëmjes nga një pjesëtarë i armatës nga zyrja e Gjeneralit na arriti lista me objektiva të rinjë të lëvizjes së trupave serbe në teren, mirëpo kësaj here nga Shtabi Ushtarak i Rinasit na u kërkua që ne të shkojmë në zyrën e Gjeneralit Lama për t'i verifikuar ato caqet direkt me Gjeneralin. Në orën 21:00 të mbrëmjes, arritëm të zyrja e gjeneralit Lama që të bëjmë verifikimin e objektivave së bashku të cilat kishin qenë të sakta, por në të njëjtën kohë u furnizuam edhe me caqet e reja. Gjatë bisedës me Gjeneralin pasi kryem punën, atij iu faleminderuam edhe për ftesën që na e bëri një ditë më herët, për të shkuar tek manovra e Ushtrisë së Shqipërisë të cilit si me shaka i thash: "A nuk mundet si gabimisht me ia huqë cakun e me ia futë pakë më largë, andej përtej kufirit ku ende ishin forcat serbe!" Gjenerali vetëm se buzëqeshi pa thënë asgjë, mirëpo si duket Kapiteni Wiggis më kishte vërejtë, si dhe deshti ta dijë se çka i thash Gjeneralit? Kapitenit i thash, "Si po shifet Gjenerali na qenka lodhur shumë, nga angazhimi i tij në lidhje me manovrën ushtarake që patën dje, si dhe shoqërimi i tij me Presidentin e vendit Mejdanan. Në orën 22:00 të mbrëmjes, u kthyem në vendin tonë ku vazhduam edhe disa orë pune me detyrat tona të zakonshme, të përkthimit dhe verifikimit të objektivave të rinjë. Po, për t'ia bërë gati Kapiteni Wiggis për transmetim në Shtabin qendrorë të Rinasit dhe për të vazhdu me bombardimet e radhës së avionit të NATO-së.

Siç po shifej, sot nuk kishte pasë aq shumë bombardime siç kishim patur ditëve dhe netëve të më herëshme, ndoshta edhe për shkak të kohës së keqe, sepse ishte kohë me shi dhe mjegull që kishte kaplu tërë rajonin e Ballkanit.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Edhe pse sot nuk kishte aq shumë bombardime në rajonin e Kosovës, si duket për mbrenda Serbisë ishin intensifikuar

bombardimet, sepse andej po mbante moti më i kthjellët dhe pa mjegulla. Në Kosovë u sulmuar: 20 pjesë të artilerisë, 2 tanke, 1 autobлиндë,

2 pozicione mortajash, 7 copa kundërtartileri, 2 lancues të raketave të ndryshme. U sulmuar edhe: kazerma ushtarake në Prishtinë dhe Obrenovac, shtabi i MUP'it në Prishtinë, depot e karburantëve në Doljevac dhe Bor, depot e municionit në: Ferizaj, Novo Pazar, Pozhega, Kurshumli, Nish dhe Surdulicë.

Gjatë ditës së sotme objektivat kryesore kishin qenë përsëri, bombardimi i shumë fabrikave mbrenda Serbisë si dhe bombardohen edhe termocentralet dhe hidrocentrali i Gjerdabit mbi lumin Danub. Këto bombardime që kishin lënë pothuajse tërë Serbinë në errësirë, e cila gjë tani kohëve të fundit kishte fillu të bëhet si e shpeshtë dhe e zakonshme atje. U raportua nga NATO-së, se ata kishin sulmuar depon e municionit në Nish si dhe parkingun e automjeteve ushtarake si dhe aeroportin.

Gjatë ditës së sotme kishte edhe bisedime në mes të palëve serbo-ruse për zgjidhjen e problemit në mënyrën paqësore që ta përmbyllin këtë akcion të bombardimeve të NATO's sa me më pakë humbje në njerëz si dhe në ekonominë e tyre.

Sipas fjalëve envoit rus Chernomyrdin për Balkanin, ai tha se në marrëveshjen me Millosheviqin, ai kishte pranuar "në principe" tërë planin e paqës së grupit G 8, e që sipas planit t'i lejohet Jugosllavisë që të ketë 11,500 trupa paqëruejtës në Kosovë, si dhe paqëruejtësit ndërkombëtarë, dhe kërkuan që menjëherë sulmet dhe bombardimet e NATO-së të ndërpriten.

Sot gjithashtu u bombardua edhe kazerma ushtarake në Deligrad të Serbisë.

E shtunë 29 maj 1999

Këtë ditë e filluam me pak gjëra punësh, mirëpo në orën 10:00 para dite më telefonoi Gjenerali Kudusi Lama i cili më pyeti se a kishim ndonjë plan për sot? Unë iu përgjigja: "Jo, përveçse takimit të më vonshëm me ju". Pastaj më pyeti: "A ju telefonoi ndonjë nga Shtabi Amerikan në Rinas, në lidhje për ardhjen e Gjeneralit Joe Hendrix këtu në Kukës?", ne nuk dinim gjë dhe iu përgjigja se: "Jo, nuk kemi marrë kurrëfarë telefonate në lidhje për ardhjen e tij te ne!". Gjenerali Lama më tha: "Sigurisht se na qenka shumë i nxanun dhe nuk paska kohë që t'ju vizitojë edhe juve, porsa më lajmëroi se do të vijë sot që të takohet me mua. Por sidoqoftë, ti së bashku me Kapitenin Wiggis mos u largoni nga vendi i juaj dhe ju lutem që mos të shkoni askund deri pas orës 14:00 gjatë pasditës së sotme!", unë iu përgjigja: "U kry kjo punë" edhe i thashë: "Ne do të presim në vendëqëndrimin tonë për derisa të na lajmërosh ti për çfarëdo qoftë!"

I tregova Kapitenit Wiggis, dhe derisa po bisedonim dhe po rrinim aty së bashku i tërë grupi ynë, rreth orës 14:10 pas dite



04 Tetor 1999, Sojevë /Kosovë, me Gjeneralet e TMK-së Refki Suma dhe Shaban Shala

ndëgjua zhurmën e motorëve të helikopterit, dhe derisa po kërkonim lartë në qiell të hapur për të parë se kush apo çka ishte, atje lartë në horizont veçse filloi të shifej një helikopter ushtarak "Black Hawk" që po na afrohej drejt vendbanimit tone. Ishte lloji i njëjtë i helikopterit si ai që zakonisht po shfrytëzohej nga Gjenerali Hendrix! Iu drejtova njerit prej shokëve të grupit që ishte më afër meje, e që quhej Dan edhe e pyeta: "A mos ju kan lajmëruar se do të na vijë ndokush nga Shtabi Amerikan i Rinasit?", ai ma ktheu: "Jo, nuk dijmë asgjë!", e pyeta me të njëjtën pyetje edhe kapitenin Wiggis, edhe ai i habitur më tha: "Jo" dhe siç po shifej askush nuk dinte asgjë për këtë ardhje, dhe derisa në të njëjtën kohë po shifnim se me të vërtetë ai helikopter gjithënjë e më tepër po na afrohej neve edhe po vinte në drejtimin tonë, e që mbrenda pakë sekondash e pamë se ai veçse po lëshohej në lëndinën para oborrit tonë, mu para syve tanë! Në fillim menduam se nga shtabi i Rinasit po na sjellin ndonjë furnizim tonin të zakonshëm si ushqimin dhe rrobet tona të lara, kur papritmas pamë nga ana tjetër e oborrit se po na vinte edhe Gjenerali Kudusi Lama! Me vrap hymë mbrenda për tu veshë me veshjet e rregullta ushtarake, sepse mbante kohë e mirë dhe që të gjithë ishim të relaksuar në maica dhe me pantolona të shkurtëra civile, si dhe papuç!

Përderisa ne u veshmbathëm, që të dy Gjeneralët: Hendrix dhe Lama me Sebin (Sebahaten, përkthyesen shqiptare) na hynë mbrenda para dhomës tonë që kishim! Me të shpejtë dolëm nga dhoma e gjumit aty ku bëmë ndërrimin e garderobës tonë edhe u përshëndetëm me të gjithë, dhe pastaj që të dy Gjeneralët së bashku me Sebin i lame të vetëm mbrenda në zyrë, kurëse ne të gjithë dolëm jashtë. Te dy Gjeneralët me përkthyesen mbetën mbrenda në bisedë për rreth një orë. Pas kryerjes së bisedës, që të dy dolën jashtë. Pas disa minutash Gjenerali Hendrix na u drejtua grupit tonë, dhe na tha të mblidhemi të gjithë së bashku sepse don të mbaje me ne edhe një mbledhje të shkurtër. Ne

që të gjithë u mblodhëm dhe hymë mbrenda paradhomës që kishim. Gjenerali Hendrix e filloi bisedën në një mënyrë shumë shoqërore dhe shumë modeste, ai ishte personaliteti i zakonshëm i tij. Gjenerali Hendrix gjatë gjithë kësaj kohe që nga ardhja ime në Shqipëri, në Operacionin e Forcave Aleate ai gjithmone kishte qenë shumë i qetë dhe i afërt edhe modest me ne, dhe për atë i gjithë grupi ynë e donim me zemër dhe kishim simpati të madhe për të. Me fillimin e bisedës së parë edhe një herë na përshëndeti të gjithëve, pastaj secilin veç e veç na faleminderoi për punën e mirë dhe shumë me rëndësi që po bënim, pastaj na u lutë që të vazhdonim edhe më tutje ashtu në të njëjtën tempo!

Vazhdoi të flasë edhe për rëndësinë e madhe të punës që po bënim, për kushtet tona jo aq të volitshme të jetesës aty, si dhe na i shprehi levdatat që kishte për ne edhe nga vetë Gjenerali Lama. Pastaj, bisedën e kaloi dhe filloi të shprehë mllëfin kundër forcave gjakatare serbe, si dhe mllëfin më të madh që e kishte ndaj Presidentit serb Sllobodan Millosheviqit, për të cilin na tha se: "Millosheviqin dua ta gjuaj në gjunjë, edhe dëshira ime më e madhe është që ta shqelmoj atë vetë unë, që edhe dhëmbët t'ia thejme, për të gjitha ato të zeza që po i bënë popullit të pa mbrojtur dhe të pafajshëm, pra shqiptarëve. Për mua personalisht, sikur të më lenin të vendosi, unë do ta kisha kry kë të luftë shumë shpejtë, mbrenda një kohe të shkurtër, ndoshta edhe me viktima ushtarake, mirëpo kjo është rruga më efikase për këtë kriminel të njerëzimit.

Gjeneralin e Armatës Amerikane John Hendrix, e kam takuar unë personalisht shumë herë, edhe nga ai kam parë, diçka që e ka çfaqë edhe në shumë raste se me të vërtetë është shumë human edhe i ka shumë në zemër dhe e donë pa masë popullin shqiptarë. Gjenerali gjithashtu foli edhe për UÇK-në trimërinë dhe rolin e tyre. Ai na tha se ushtarët e UÇK-në janë shumë guximtarë dhe trima edhe mjaftë të diciplinar, dhe sipas tij, nëse ai veçse pak t'i kishte ushtruar ato, shumë lehtë

dhe shpejtë së bashku me to do të hynin në Kosovë pa kurrëfarë problemi, dhe do ta kishte Kosovën e lirë mbrenda një kohe të shkurtër, kundër atij grupi paramilitaro-ushtarako-policorë jo-profesional, gjakatar dhe kriminel të cilët po sulmojnë popullin e pa armatosur dhe të pafajshëm...

Pastaj nga ne kërkoi që për caqet e bombardimeve të informohet sa më shpejtë që është e mundur, duke u dhënë përparësi atyre ku më së tepërmi rrezikohet popullata civile. Ai gjithashtu na porositi që të jemi shumë të kujdesëshëm për çdo lëvizje tonën, për shkak të sigurisë sonë, sepse edhe shumë lehtë mundë që të kenë depërtu pjesëtarët e armikut serb edhe në këto anë të Shqipërisë. Më vonë na pyeti se a kishim ndonjë kërkesë apo nevojë për ndonjë send nga komanda e tij: si për ushqime apo edhe pije (kuptohej, jo alkoholike) apo çfarëdo qoftë.

Ne i çfaqëm kërkesën tonë, që sipas mundësive për shkak se s'kishim kurrëfarë mundësie që të kontaktonim familjet tona me telefon, edhe atë që të na japin një telefon satelitor, për çka edhe gjenerali Hendrix u pajtua dhe na tha se do të bëjë gjithëçka që është e mundur për të na i plotësu kërkesat tona. Ai na premtoi se do të mundohet t'na ndihmojë për gjithëçka që është e mundur. Pas kësaj bisede që të dy Gjeneralët u larguan secili në drejtimin e vetë.

Në orën 20:00 të mbrëmjes, Gjenerali Kudusi Lama na thirri që të shkojmë për të na e dhënë listën me objektivat e rinjë të armikut serb, dhe për t'i bërë gati për bombardimet e ardhëshme të avionit të NATO-së.

Objektivat që i morëm kësaj here ishin lokacionet për rreth Zhurit, ku ishin të përqëndruara shumë forca serbe, me artileri të rëndë dhe mjetet tjera luftarake. Pas marrjes së këtyre informatave përsëri u kthyem në zyrën tonë ku bëmë punën e zakonshme, përkthimin dhe verifikimin e koordinatave ushtarake, dhe pastaj përcjelljen e tyre nga Kapiteni Wiggis drejt Shtabit të Rinasit dhe kështu me rradhë deri në bombardimet e tyre. Pas kësaj

pune të zakonshme sa për relaks ngjiteshim lartë mbi pullazin e objektit tonë, kuptohet për të pushuar dhe për t'i përcjellë në qiellin e hapur fluturimet e aviacionit bombardues të NATO-së, që shpeshherë mund t'i shifnim mbi hapësirën ajrore të Kukësit para hyrjes së tyre apo edhe pas bombardimeve në kthim nga Kosova. Në pullazin e banesës kishim edhe antenat e radio-lidhjeve satelitore, prej nga mund të ta bënim edhe vëzhgimin më të mirë të tyre. Gjatë mbrëmjeve të errëta shumë akcione që ishin zhvillu në afërsi të kufirit kishim mundësi që ta shifnim dhe ndëgjoni bombardimet e tyre, të akcionit të aeroplanëve bombardues të NATO-së mbi trupat serbe mbrenda Kosovës. Vëzhgimi nga pullazi, për ne ishte edhe atrakcioni dhe argëtimi kryesorë që kishim në këtë pjesë jashta qytetit të Kukësit në Shqipëri, me të cilin argëtim dhe detyrë sa më duket që të gjithë ishim të kënaqur!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme pati 639 fluturime dhe gjithashtu u qëlluan: 17 armë artilerie, 2 tanke, autoblanda, 2 pozicione mortajash, automjetet ushtarake, u qëlluan edhe aeroportet në Ponikve dhe Sjenice, depot e municionit në: Velejevë, Mitrovicë, Kurshumli, Prishtinë, Boljevac, Vërshac dhe Kraljevë si dhe depo karburanti në aeroportin në Batajnicë. U qëlluan edhe kazermat ushtarake në Prizren, Sremska Mitrovicë dhe Çupri. Në Nish u sulmua edhe rilei i radios FM dhe i TV. Sipas Ma. Gjeneral Walter Jertz tha se sulmi në Camurlija u bë mbi kazermat dhe caqet ushtarake. Gjatë ditës së sotme u qëllua edhe ura në Donje Trnjance. Në këtë ditë u sulmua edhe tuneli në fshatin Kerk Bunar në mes të Brezovicës dhe Prizrenit i cili po përdorej nga ushtria serbo-jugosllave si vendëstrehim nga bombardimet e NATO-së. Në Kosovë pati sulme edhe në rrethin e Vitisë si dhe në Budrigë të epërme.

E diel 30 maj 1999

Siç po shifej tani, që nga ndërrimi i hartave topografike, dhe pas takimit në mes të Gjeneralëve Hendrix dhe Lama dhe Kolonelit Hannes, gjërat po lëvizin shumë më mirë dhe më tepër sakta se sa në fillim. Edhe m'u për atë ishin edhe sulmet e bombardimeve shumë më të suksesëshme. Po e them kështu sepse gati se çdo ditë e më tepër po vijnë në rritje sukseset dhe sulmet mbi forcat serbe. Edhe sot para dite, filluan goditja e objektivave që i kishim dhe ne mbrëmë vonë, kishin filluar të qëllohen me të madhe nga bombarduesit e aviacionit të NATO-së dhe tani po na kërkohen edhe shumë më tepër objektivat edhe më të reja të lëvizjes së trupave serbe direkt prej nesh! Pas dite dolëm në pazarin e Kukësit, për të blerë edhe disa gjëra që kishim nevojë. Gjatë furnizimit na u deshtë të endemi rrugës nga

dyqani në dyqan deri në qendrën e qytetit të Kukësit, atje ku gjeta një kiosk të vetme me gazeta dhe revista. I thash Kapitenit Wiggis të më presë pak për derisa të marr ndonjë gazetë apo revistë që kishte aty. Aty bleva disa gazeta dhe gjeta edhe një libër të vogël nga personi të cilin e kishim idol të patriotizmit dhe intelegjencës së Shqiptarisë, një libër nga Ukshin Hoti. Menjëherë pas kësaj derisa po bredhni rrugës, rastesisht takuam 3 ushtarë të UÇK-së të cilët ishin në moshë dhe me uniforma ushtarake të Ushtrisë Amerikane, por edhe me amblemat e UÇK-së në njërin supe, kurse në supen tjetër kishin flamurin Amerikan. Ishin ata pjesëtarët e Batalionit Shqiptaro Amerikan "Atlantiku", të ardhur nga SHBA për të ndihmuar vëllezërit dhe motrat e tyre. Ishin nga batalioni të cilit dhe vetë unë po planifikoja që t'i bashkangjitem pakë para se vendosa që t'i bashkangjitem Armatës Amerikane. Me të parë ata neve, që të tre ngurruan dhe na u afruan të na pyesnin se ç'po bënim ne këtu, si dhe prej nga ishim. Gjatë bisedës na njoftuan se kishin pakë pushim nga fronti i luftës, dhe se po shrytëzonin kohën për ta vizituar një shok të tyre të luftës që ishte plagosur dhe tani qenka në kurim në spitalin e Kukësit, ku po shërohej nga plagët e marra në luftë. Na treguan se ishin pjesë e Batalionit "Atlantiku", ku ishin një numër i madhë i tyre të cilët kishin lënë fëmijët dhe familjet e tyre në SHBA dhe kishin ardhur për t'i tregu armikut serb se si luftohet! Na treguan se kishin korrë suksese të mëdha në shumë fronte kundër armikut gjakatar serb, dhe se kishin vrarë një numër të madh ushtarësh serb, si dhe i paskan shkaktuar edhe dëme të mëdha në material ushtarak.

Njëri prej tyre ishte nga Nju Jorku (New York), tjetri nga Filadelfia (Philadelphia-Pennsylvania) si dhe i treti ishte nga Kanetikat (Connecticut). Ushtari nga Filadelfia na tha se ishte me prejardhje nga rrethi i Kaçanikut

me mbiemerin Kuka, kurse ushtarët tjerë nuk arrita t'i pyes për prejardhjen e tyre pasi se Kapiteni Wiggis shifej se e kishte siklet, dhe nuk ishte i kënaqur që ne të shifeshim së bashku me pjesëtarët e UÇK-së në mes të qytetit të Kukësit, e që kuptohet për shkaqe të marrëveshjeve që kishim nga Shtabi Ushtarak Amerikan, si dhe nga Marrëveshja NATO- OKB. Pas ndarjes prej këtyre ushtarëve të UÇK-së vazhduam më tutje për në pazar, për të blerë edhe disa pemë dhe perime, kur në ndërkohë në radio-lidhje na erdhi lajmi se për menjëherë duhet të shkojmë në zyrën tonë sepse më paskan telefonuar mua nga zyreja e Gjeneralit Lama për të shkuar dhe për të marrë informacionin më të ri për sot të detyrës që kishim. Ende pa e kry tregëtimin na u deshtë që të ikim menjëherë për në zyrën tonë. Në të kthyer në zyrë, unë me kapitenin morëm gjërat e punës dhe vazhduam rrugën për në zyrën e Gjeneralit Lama, edhe pse kësaj here Gjenerali nuk ishte aty. Kapiteni Wiggis menjëherë kërkoi të takojë cilin do qoftë që po zavendësonte Gjeneralin Lama. Kësaj here te zyrra e Gjeneralit takuam dy ushtarakët shqiptarë: Shyqyri Shabanin (Shef i Zbulimit) dhe Selim Spahiu (Shef i Gjeneral Shtabit) për të cilët nuk e dija saktë se çfarë grade ushtarake kishin. Biseduam rreth pikave të reja të sulmit për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë, sepse tani kishim bombarduesit e aviacionit të NATO-së që po fluturonin mbi qiell, dhe po na kërkonin caqe të reja. Objektivat që i morëm mbrenda një kohe të shkurtë rreth 30 minutash i bëmë gati dhe Kapiteni Wiggis me kolegët tjerë menjëherë e mori në radio-lidhje Shtabin në Rinas dhe ia përcolli caqet më të reja. Mbrenda një ore veçëse filluan sulmet nga bombarduesit e aviacionit të NATO-së, kësaj here sulmet filluan mbi malet e Koshares, pastaj edhe në Planeje dhe

Verbnicë. Këto sulme patëm fatin t'i përcjellim nga pullazi i pallatit tonë, aty ku pjesëtarët e grupit kishim ndërtuar tavolinë druri me karrika për rreth.

Në orën 20:00 më mori në telefon njëri nga oficerët e Ushtrisë së Shqipërisë që e takuam pakë kohë më herët, ishte Shefi i Gjeneral Shtabit z.Selim Spahiu i cili na thirri për të na treguar se atë sapo e kishin lajmëruar dhe njoftuar nga Shtabi i UÇK-së, se sapo ishte kryer ekzekutimi i sulmit të suksesëshëm nga aviacioni i NATO-së drejt caqeve të më herëshme që kishim marrë prej tyre, mbi forcat e armikut paramilitaro ushtarako policore serbe. Ky sulm ishte parë edhe nga Forcat e Shqipërisë, që ishin të përqendruara për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë. Sulmet në këto pika vazhduan edhe deri vonë gjatë natës, sulmet të cilat mundëm t'i shofim gjatë errësirës së mbrëmjes nga drita dhe kërsimat e shpërthimeve të bombave dhe raketave nga NATO-ja jo aq largë kufirit Shqipëri-Kosovë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë 24 orëve të fundit NATO kishte numrin më të madhë të fluturimeve me 772, dhe me sukses sulmuan: 12 tanke, 7 armë artilerie, 6 autoblanda, 2 pozicione mortajeh, 1 radar, automjetet ushtarake dhe pozicionet ushtarake. Gjithëashtu bombarduan edhe shumë qytete tjera mbrenda Serbisë si dhe Surdulicën. Zëdhënësi i NATO-së, Kol. Konrad Freitag tha se në Surdulicë gjatë sulmit të mesnatës sot u qëllua edhe depoja e armëve si dhe kazerma ushtarake, kurse në orën 7:20 të mëngjesit ishte goditur edhe kazerma ushtarake në Vranjë, pastaj në Novi Pazar, Aleksinac, Surdulicë, Gjilan dhe Beograd. Në orën 13:25 qëllohet edhe ura mbi lumin Morava në Varvarin të Serbisë. Gjithëashtu sulmohet edhe në afërsi të fshatit Katun dhe

Meredovac. Sot u sulmuan edhe pikat kufitare në Burovik, Dunav, Slavujevac dhe Preshevë. U sulmuan edhe depot ushtarake në Besinje, Beograd, Ostruznica, Vuçitërn dhe Leskovc. Sot u sulmuan edhe posti i mbrojtjes ajrore të Novi Sadit dhe Rakovicë, depot e municionit në: Mitrovicë, Surdulicë, Prishtinë, Gjilan dhe Nish. U qëlluan gjithëashtu dhe u shkatërruan depot e karburantit në Leskovc, Kraljevë dhe Somobra si dhe tuneli i autostradës e cila po shfrytëzohej nga forcat serbe si magazinë në Sremska Kamenicë. Sulme tjera u bënë edhe mbi bunkerin ushtarak në malin Avala afër Beogradit si dhe qëllohen edhe kazermat dhe magazinat ushtarake në Zuce në shpatijet e Avalës në afërsi të Beogradit. Gjithashtu shkatërrohet edhe Radio stacioni AM i Beogradit.

E hënë 31 maj 1999

Sot mbante kohë e mirë, kishim një ditë të bukur me diell edhe atë që nga mëngjesi. Nuk e dije se pse, por mu kujtua një thënie e të madhit të kombit tone Sami Frashërit "Pasuria dhe drejtësia janë ato që i duhen njerëzimit", e sa më duket sot që të dyja i kishim në dispozicion. Po bëhet një luftë e drejtë dhe si pasuri kishim në dispozicion flotën më të madhe ushtarako ajrore-amerikane, sepse në këtë arenë ne të "Operacionit të Forcave Aleate" për Kosovë ishin mbi 70% nga forcat amerikane ose siç po e quajnë atë të NATO-së. Të shtënat në mes armikut serb dhe UÇK-së, filluan të ndëgjohej sot qyshë në orët e herëshme të mëngjesit, në agim. Siç po ndëgjojmë këtu në qytetin e Kukësit, armiku gjakatarë serb po përdorë armë artilerie dhe lloje tjera të armatimit të rëndë, duke gjuajtur prej së largu në distancë, ndoshta nga Planeja, Verbica, Gorzhupi, Zhuri etj. Forcat e armikut ishin të fortifikuara mirë ditë më parë, e ndërsa trupat e UÇK-së me ndihmën e aviacionit të NATO-së po mundohen që ta shpërthejnë atë mburojë të fortifikimit të hekurt nga kufiri shqiptaro-shqiptarë në afërsi të Morinës. Gjithashtu po ndëgjojmë se po zhvilloheshin luftime të UÇK-së me ato të armikut serb të cilat ishin shumë të repta. Nga krismat e armëve të kalibrave të ndryshëm që po ndëgjonim këtu ku ishim në Kukës, ishte ngritë pezull Kapiteni Wiggis, doli nga zyreja dhe erdhi te paradhoma edhe na thonte se tani na duhet bërë diçka, sepse tani kemi në dispozicion sa të duam fuqinë ajrore të NATO-së edhe atë për të sulmuar ku të duam dhe sa të duam. Tani më shumë se kurrë na duheshin sa më tepër që është e mundur objektivat e reja të forcave serbe se ku po ndodheshin apo nga po shkonin sepse tani ishte koha dhe duhej bombarduar me më shumë sulme dhe sa më saktë! Na duhej informacion i rijë dhe me tempo më të shpejtë, për t'ia ndërpre të gjitha lëvizjet forcave të armikut serb. Para orës 7:00 të mëngjesit i telefonuam Gjeneralin Lama që të takohemi për konsultim te disa caqeve më të herëshme, dhe sipas mundësive të na gjejë edhe objektivat më të reja.

Vijon



23 Mars 2001 Gjilan /Kosovë, takimi me Komandant "Remin" Rrustem Mustafa në kazermën e TMK-së në Gjilan / Kosovë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Zhegrova: Do të rikthehem shpejt te fitorja

PRISHTINË, 30 MARS - Edon Zhegrova ishte shënues për Përfaqësuesen e Kosovës në ndeshjen ndaj Andorrës, e cila përfundoi baras 1-1. Anësori "dardan" ka mbetur me zemër të thyer nga

dështimi i Kosovës në ndeshjen e dytë kualifikuese për Kampionatin Evropian, por është zotuar se shumë shpejt "dardanët" do ta gjejnë rrugën e fitores. "Zemërthyer me rezultatin

ndaj Andorrës. Dëshëm të fitonim për juve që na përkrahët në borë e acar, por nuk ishte nata jonë", ka shkruar fillimisht ylli i Lilles në rrjete sociale. "I nderuar dhe krenar që e përfaqësoj

shtetin tim dhe gjithmonë me përgjegjësi do ta vesh fanellën e Kosovës për t'ju bërë krenarë. Do të rikthehem shpejt te fitorja. Faleminderit!", ka shtuar Zhegrova.



Ndërron jetë futbollisti 15-vjeçar Leon Syla

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 MARS - Futbollisti i ri i 2 Korrikut, Leon Syla, ka ndërruar jetë papritmas në moshën 15-vjeçare. Lajmin e ka dhënë klubi prishtinas, që pas ngushëllimit të familjes, e ka vlerësuar Leonin si një djalë luftarak në fushën e futbollit, po ashtu edhe jashtë saj, sepse luftoi fortë me sëmundjen e rëndë që e kishte, por si një djalë trim e i patrembur me luftën e mosdorëzimitin e tij ka treguar se sa shumë e donte jetën e futbollin. "Leoni vetë si djalë i fortë që ishte, do të mbetet shembull i vërtetë për çdo shok e shoqe të rrethit të tij dhe jo vetëm; Leonin do ta kujtojmë me mall tërë jetën", thuhet në njoftimin e 2 Korrikut.

Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Federata e Futbollit të Kosovës kanë dërguar telegram ngushëllimi pas ndarjes nga jeta të futbollistit të ri Leon Syla. "Ikja e tij e hershme shkaku i sëmundjes që e përcolli për disa vjet preku gjithë komunitetin e sportit dhe jo

vetëm. Leoni ishte shembull për shpirtin e tij luftarak dhe disiplinën e shfaqur në klub dhe aktivitetet sportive. Në emër të KOK-ut dhe lëvizjes olimpike në vend, i shpreh ngushëllimet më të thella familjes së tij, shokëve, Klubit 2 Korriku, FFK-së dhe gjithë afërmeve të tij", thuhet në telegramin e KOK-ut.

Ndërsa FFK-ja ka konsideruar se vdekja e hershme e futbollistit Leon Syla është e rëndë dhe nuk ka fjalë të mjaftueshme për ta shprehur dhimbjen për humbjen e një djaloshi të ri dhe të talentuar sikur ishte Leoni. "Ikja e tij e hershme nga kjo botë preku zemrat e gjithsecilit në komunitetin e futbollit. Leoni ishte shembull i vërtetë luftaraku jo vetëm në fushën e futbollit, por edhe në betejën e tij me sëmundjen e rëndë. Sot të gjithë jemi me lot në sy dhe dhimbje në zemër, por shpresojmë që kujtimet e bukura dhe sukseset e Leonit do të jenë burim ngushëllimi dhe force për ju për ta përballuar dhimbjen e madhe", thuhet në telegramin e FFK-së.



Rahoveci - Prishtina, derbi në Superligën e hendbollit

Rahovec, 30 mars - Xhiroja e 24-t e Superligës A të Kosovës në hendboll (meshkujt) fillon me derbin në mes të Rahovecit dhe Prishtinës. Kjo ndeshje zhvillohet të premten prej orës 20:00 në Rahovec. Skuadra vendase është në krizë rezultatesh dhe do të mundohet të dalë prej saj pikërisht në derbin ndaj

Prishtinës. Ndërkohë skuadra kryeqytetase ka reaguar së fundi pas një serie negative dhe do të mundohet ta vazhdojë ngritjen. Ndeshja vlerësohet me peshë të madhe në garën për plejof. Aktualisht Prishtina është e treta me 23 pikë. Rahoveci është i pesti me 21 pikë dhe synon fitoren për t'u barazuar

me pikë me skuadrën prishtinase. Xhiroja e 24-t vazhdon të shtunën me ndeshjen Kastrioti - Trepça, që zhvillohet prej orës 17:00. Të dielën prej orës 20:30 është takimi tjetër interesant, Vushtrria - Besa Famgas. Vushtrriasit do të përpiqen t'ia shkaktojnë humbjen e parë lideres, Besës.

Në pesë muajt e fundit Muriqi i rritet vlera pesë milionë euro

Prishtinë, 30 mars - Sulmuesi Vedat Muriqi është një prej sulmuesve më të mirë të Përfaqësueses së Kosovës. Në ndeshjen e fundit që Kosova

zhvilloi kundër Andorrës, 28-vjeçari pati disa raste për të shënuar, të cilat nuk arriti t'i shfrytëzojë. Sipas uebfaqes gjermane "Transfermarkt",

vlera e futbollistit në fjalë është rritur pesë milionë euro gjatë pesë muajve të fundit. Më 7 nëntor të vitit të kaluar vlera e tij ishte 10 milionë

euro, ndërsa tani vlera e tij është 15 milionë euro. Kujtojmë se Muriqi aktualisht është pjesë e klubit spanjoll Mallorca.



Rikthimi i basteve në Shqipëri, Ylli: Do të jenë veç online për personat mbi 18 vjeç

TIRANË, 30 MARS - Ditën e martë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se bastet sportive do të rikthehen shumë shpejt. Rikthimi i basteve online në vend do të ketë disa rregulla të rrepta për të ndaluar që të luhet edhe nga persona nën

moshën 18-vjeçare. Kreu i Komitetit Olimpik, Fidel Ylli, tregon risitë e projektligjit që është në diskutim. Ai bëri me dije se bastet do të vihen vetëm online nëpërmjet një llogarie bankare dhe se personat të cilët vendosin të luajnë do të

paguajnë 15 % të shumës në rast se fitojnë. "Po ta shikosh ligjin e kompanive të basteve para se të mbylleshin, ishte bërë një ligj i standardeve evropiane, por duke qenë se jetojmë në Shqipëri, në një vend ku korruptohet kushdo, ato kishin dalë jashtë

kontrollit që në kohën e PD-së, por edhe më pas. Nëse ligji thoshte se një pikë bastesh duhet të jetë 300 metra larg pikës tjetër, ti i kishe ngjitur. Me ligjin e ri lojtari do të paguajë 15 % të asaj që do fitojë, që deri dje nuk ka qenë", ka thënë Ylli.



Mulleri paralajmëron Dortmundin: Ndaj tij si ndaj PSG-së

MÜNCHEN, 30 MARS - Bundesliga rikthehet pas pauzës së kombëtareve me "Der Klassiker", në program këtë të shtunë në 18:30. Bayern Munchen - Borussia Dortmund, "armiqtë" e mëdhenj, përplasen këtë të shtunë në një akt të jashtëzakonshëm rivaliteti, që vlen më së paku kryesimin në futbollin gjerman, por që mund të rezultojë edhe një gur i rëndë në luftën për titullin kampion.

Dortmundi udhëton drejt rivalëve "bavarezë" me 1 pikë më shumë në krye të klasifikimit, çka e bën sfidën edhe më të zjarrtë me ish-trajnerin e Borussia, Thomas Tuchel, që debutoi pikërisht ndaj ngjyrave verdhezi në stolin e Bayernit. Thomas Muller është një nga ata që e di se çfarë duhet për ta mundur Dortmundin. Gjithashtu, ai e di se si ndihesh kur humbet ndaj tyre, teksa shpjegon pikë së pari si e presin këtë përballje. "Synimi ynë është ta fitojmë titullin e Bundesligës. Në kërkim të jemi gjithmonë të suksesshëm dhe kjo nuk ka ndryshuar. Ne jetojmë për momente si ato kur luan në shtëpi ndaj PSG-së dhe i gjithë stadiumi të mbështet. Janë emocionet se përse ne stërvitemi. Tani e njëjta skenë është ngritur pasi në Klasike do të kemi të njëjtat emocione, por na duhet të punojmë shumë për këtë", ka thënë Muller.



Bayerni nuk ka humbur në shtëpi në Bundesliga përballë Dortmundit që nga 2014-a. "Borussia gjithmonë ka një skuadër që luan futboll sulmues dhe ka lojtarë të mirë në sulm. Kjo do të thotë se është diçka normale që ka shënuar shumë gola në këto ndeshje. Rekordi ynë ndaj tyre duket i mirë dhe e kemi ndier këtë në vitet e fundit, ndaj duam të vazhdojmë. Kur shikon Dortmundin tani, ka pasur rezultate shumë të mira dhe pëson më pak gola, kështu që të shohim se çfarë do të ndodhë", u shpreh lideri bavarez. Si rrallëherë në këtë sfidë Dortmundi vjen duke i parë nga lart poshtë në klasifikim rivalët e vjetër,

diçka me të cilën Muller natyrisht nuk është mësuar. "Është një ndjesi e keqe, sepse më parë duhet t'i vendosësh këmbët në tokë pasi ke rrëshqitur. Kjo ndodhi me ne në javën e fundit të kampionatit dhe pas asaj humbje me Leverkusenin jemi ndierë vërtet keq. Tani na duhet të fitojmë kundër Dortmundit. Do të shkojmë për tifozët tanë në 'Allianz Arena' me ndeshje si ajo ndaj PSG-së në mendje. Ne jemi mësuar të luajmë nën presion dhe rëndësia e kësaj ndeshjeje është shumë më e madhe sesa ka qenë në vitet e kaluar për shkak të situatës aktuale", ka shtuar veterani gjerman.

Milwaukee dominon në Lindje, lakersat fitojnë me dyshen Davis - James

CHICAGO, 30 MARS - Fitorja e 55-të sezonale për Milwaukee, që e mposhti 149-136 Indianan jashtë fushës, duke komanduar në Konferencën e Lindjes. Giannis

Antetokounmpo, protagonist në fushë me një "triple double", me 38 pikë, 17 rebounde e 12 asistime. Gjithsesi, shënuesi më i mirë për Bucksin ishte Holiday me 51 pikë. Fitoi edhe ekipi i Lakersave, që mundi me rezultat 121-110 Chicagon, duke u hakmarrë për humbjen e pak ditëve më parë. Davis me 38 pikë e 10 rebounde si dhe LeBron me 25 pikë ishin protagonistë për miqtë. Philadelphia, falë 25 pikëve të Joel Embiidit, mundi me rezultat 116-108 Dallasin, që rezikon të qëndrojë jashtë "play-off"-it. Ekipi i Phoenixit mundi me rezultat 107-100 Minnesotan, ndeshje ku të gjithë titullarët e Sunsit realizuan mbi 10 pikë (Bookeri me 29 pikë më i mirë). Clippersat, falë 36 pikëve e 10



asistimeve të Westbrookut, mundën me rezultat 141-132 Memphisin, ndërsa Oklahoma fitoi në sekondat e fundit me shifrat 107-106 ndaj Detroitit, ndeshje ku u dallua Williams me 27 pikë.

REZULTATET

Indiana - Milwaukee	136-149
Brooklyn - Houston	123-114
New York - Miami	101-92
Philadelphia - Dallas	116-108
Chicago - Lakers	110-121
Memphis - Clippers	132-141
Oklahoma - Detroit	107-106
San Antonio - Utah Jazz	117-128
Phoenix - Minnesota	107-100
Portland - Sacramento	80-120

Messi do të rinovojë me PSG-në, synon të jetë në Botërorin e ardhshëm

E ardhmja e Lionel Messit në Francë me PSG-në u vendos në dyshim duke qenë se kontrata e sulmuesit me kryeqytetasit mbyllet në fundin e sezonit

aktual. Plani i argentinasi është që të rinovojë me klubin francez të paktën edhe për një sezon e më pas të largohet drejt Amerikës aty ku ka kërkesa të

shumta nga klubet e MLS-së. Duke u aktivizuar në MLS, numri 10 fiton kohën e nevojshme për t'u përshtatur në një territor të ri pasi një tjetër

objektiv është Botërori i vitit 2026 që është përcaktuar të zhvillohet në Amerikë, Kanada dhe Meksikë. Messi kërkon të luajë me Argentinën si një

Kampion Bote në eventin më të rëndësishëm futbollistik, pse jo për të synuar një tjetër titull edhe pse në vitin 2026 do të ishte në moshën 39-vjeçare.

SHKURT

Kovaqi refuzon ofertën e Tottenhamit

Tottenham Hotspuri ndodhet në një "krizë" trajnerësh pas shkarkimit të Antonio Contes, me drejtuesit e klubit anglez që kanë nisur punën për ta zëvendësuar. Por kjo gjë nuk duket aspak e lehtë, sepse shumë emra që ndodhen në listën e "Spurs"-it duket se nuk janë të gatshëm ta marrin drejtimin e skuadrës nga Londra. I radhës ishte ai i Niko Kovaqit. Ish-trajneri i Bayernit, i cili aktualisht drejton Wolfsburgun, nuk është bindur nga drejtuesit aq sa duhet, saqë ka zgjedhur ta vazhdojë punën në Gjermani. Në listë ndodhen edhe Julian Nagelsman e Oliver Glasner, por të dy ndodhen në orbitën e Realit të Madridit.

Havertz: Chelsea më bleu për 80 milionë euro, njerëzit menduan se isha Messi

Kai Havertz zbarkoi në Angli në vitin 2020. Chelsea e bleu atë për 80 milionë euro nga Bayer Leverkuseni dhe kjo nuk ishte e lehtë për përshtatjen e lojtarit në futbollin anglez, gjë për të cilën ai e pranoi në një intervistë për "Guardian". "Nuk e kuptoj se si mund të paguhen kaq shumë para për një lojtar, por në futboll kjo gjë është normale. Kjo sjell shumë presion. Njerëzit mendonin se isha Messi. Isha vetëm 20 vjeç. Ata thjesht shohin çmimin që pagoi klubi dhe ti duhet të luash mirë që nga dita e parë. E ndien shumë atë presion", ka thënë sulmuesi gjerman.

Barça i ofron kontratë të re Xavit

Barcelona dhe Xavi Hernandezi do ta vazhdojnë bashkëpunimin. Sipas raportimit të Fabrizioo Romanos, është vetëm çështje kohë zgjatja e kontratës së Xavit me Barçën. Klubi e ka gati propozimin për marrëveshjen e re, me trajnerin, por aktualisht pëlqen të fokusohet te ndeshjet e ekipit. Trajneri dhe bordi kanë punuar më parë për planet e klubit, ndërsa dëshira e tij është që në këtë sezon ta fitojë kampionatin spanjoll e pastaj ta nënshkruajë kontratën e re.

De Gea refuzon rinovimin e kontratës me Unitedin

David de Gea e ka refuzuar ofertën e Manchester Unitedit për kontratë të re. "The Athletic" raporton se Unitedi është i interesuar t'ia vazhdojë qëndrimin, por dëshiron t'ia ulë pagën e majme, gjë që portierit nuk i pëlqen. Megjithatë, ai duhet ta pranojë këtë gjë nëse dëshiron të mbetet në klub. Sidoqoftë, negociatat vazhdojnë dhe parashikohet të kenë një përfundim pozitiv për të dyja palët. De Gea është pjesë e klubit nga "Old Trafford" nga viti 2011 kur ishte transferuar nga Atletico Madridi dhe ka regjistruar mbi 500 paraqitje.



Shoqata Humanitare Barmëse e Kosovës "Mëna Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobrotvorno Udruženje Kosovo "Majka Teresa"
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, p.k. 141/00181 10 542-864, Fax: 542-869,
Web site: www.mtheteresa.org e-mail: mtheteresa@yahoo.com

CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 30/03/2023

Procurement No	Training	002	2022	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Training for 150 Women beneficiaries & Capacity Building for 5 BMO-s
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)
<input checked="" type="checkbox"/> Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Training for 150 Women beneficiaries & Capacity Building for 5 BMO-s
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000-8 <input type="checkbox"/>
II.1.7) Variants are accepted <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
II.1.8) Division into lots <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/> X
Lot 1 Training for 100 Women Beneficiaries Lot 2 Training for 50 Women Beneficiaries from Vulnerable Group Lot 3 Capacity Building for 5 BMO-s

II.1.11) Estimated contract value: Lot 1 20,000.00 Euro approximately Lot 2 17,000.00 Euro approximately and Lot 3 11,700.00 Euro approximately

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 month (from the contract signature)
or
Starting Lot 1 01.05.2023 Start Lot 2 01.05.2023 Start Lot 3 01.05.2023 Start
20.06.2023 Finish 20.06.2023 Finish 20.06.2023 Finish
Completion 30/06/2022

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. Business Registration Certificate 2. List of proposed experts and administrative staff and their CV-s 3. References of previous experience in similar projects Documentary evidence required: Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo 2. Court Certificate only for Winner 3. Company profile Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity 1. Business License Certificate Documentary evidence required: Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x

III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service Yes No

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure
<input checked="" type="checkbox"/> Open

IV.2) AWARD CRITERIA

LOWEST PRICE

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 07/04/2023
Payable documents <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Additional information Date 12/04/2023 time 14:00 place Prishtina
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders <input checked="" type="checkbox"/> no
IV.3.5) Is tender security needed: <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
IV.3.6) Tender validity period: date: 20/04/2023 days 30 or months 1
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 20/04/2023 time 14:30 place Prishtina

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erblin Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Ekonomike "Kadri Kusari".

- Martin Marku nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u "At Gjergj Fishta" nga kl. I-V dhe VI-IX Bishtazhin KK Gjakovë.

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në Rracaj komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.05.2023 në ora 10:00 në sallën e ndërtesës së Kuvendit Komunal në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82121245570?pwd=WHlib3RvVi9HYWUwMGFtYVNUK0dlZ09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C. Prishtinë për parkun e energjisë diellore në Rracaj komuna e Gjakovës.

<https://mmpi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "ELEGANT SILVER" SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të unik: **811922112** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazette.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "ELEGANT SILVER" SH.P.K. u Prizren, doneo odluku da ugasi biznis po br. Registra: **811922112** I ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "ELEGANT SILVER" SH.P.K. in Prizren has come to the decision to quit its business with registry: **811922112**. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT


SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH. A.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Neni 21 dhe neni 21.4, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative pika 15.3 për Ndërmarrjet Publike. Bazuar në Vendimin Nr.09/2022 të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, me numër të protokollit 01-59/9, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës Ri-shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli: Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit – ZKFTH

Numri i Referencës: ZP/KJ-3-2023.

I raporton: Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: Niveli II.

Orët e Punës: 40 orë në javë.

Mandati: 3 vite me mundësi vazhdimi.

Vendi i punës: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari Kryesor Financiar dhe Thesarit të Kompanisë (ZKFTH) do të menaxhojë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-se si dhe punët shtesë sipas nevojës të kërkuara nga KE-ja, çështje financiare të Kompanisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i Drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Kompaninë dhe do të jetë përgjegjës që:

- Të mirëmbajë llogaritë e kompanisë të azhuruara dhe të sakta;
- Të themelojë dhe të udhëheqë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- ZKFTH në nivelin kryesor të subjektit publik, është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhënës ndaj Zyrtarit kryesor administrativ për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit publik.
- ZKFTH është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve financiare të subjektit të sektorit publik për garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë së:
 - ✓ dokumentit final të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të planifikimit të subjektit publik;
 - ✓ raporteve periodike për monitorimin e buxhetit për vendimmarrësit;
 - ✓ transaksioneve financiare, kontabilitetit dhe pasqyrave vjetore financiare të subjektit publik në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave Punes dhe Transfereve;
 - ✓ rregulloreve të brendshme të menaxhimit financiar, hartimit të proceseve dhe fushat me rrezik, duke siguruar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset në kuadër të subjektit dhe listat për kontroll financiar për të gjithë personelin e financave të subjektit publik.
- ZKFTH ngarkohet me zbatimin e përgjegjësisë sipas nenit 8 të këtij Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike;
- Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikën e korporatës dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Të përgatisë të dhënat e kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve të KMDK SH.A.;
- Të menaxhojë thesarin e kompanisë;
- Të vendosë dhe përgatitë buxhetin;
- Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlidhen me pozitën e caktuar;
- Detyra tjera të përcaktuara nga ana e KE dhe udhëzimet nga BD; dhe
- Për punën e tij i përgjigjet BD dhe KE.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë universitare e Fakultetit Ekonomik,
- Përvojë pune profesionale së paku 3 vite në fushën e financave dhe kontabilitetit.

Aftësitë kryesore:

- Demonstrim i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e kompanisë;
- Të ketë njohuri në programin e kontabilitetit "Quick Books".

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara e punës:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pika d, f, j, k, l dhe (iii) kanë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, me kusht që (i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Preferohet të jetë kontabilist i çertifikuar nga ndonjë autoritet i licencuar nga KKRF-ja apo ndërkombëtar,
- Preferohet të ketë përvojë menaxheriale në fushën e financave të sektorit publik,
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të të cilave raporton Ndërmarrja,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrën e KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e KMDK SH.A në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakrishtë". Tel: 038/ 600 – 552.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni,
- CV e detajuar (formati Europass),
- Kopja e letërnjoftimit ose Pasaportës me afat,
- Letër e Motivimit,
- Kopje e Diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për Diplomat e marra jashtë vendit;
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga Institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që e përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qene te detyruar të paguajnë në këtë Institucion);
- Deklarata nën Betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 te Ligjit të NP-së e cila mund te shkarkohet ueb faqja e Kompanisë;
- Çertifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë kalendrike nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së <https://kmdk-ks.org/?page=1,7> duke filluar nga data: 31.03.2023 deri me datën 01.05.2023 ora 08:00-16:00h.

Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë. Dokumentacionet të dorëzohen me zarf të mbyllur.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 552.



Kompanija për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Priština, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551, 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU SH. A.

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima član 21 i član 21.4, na osnovu člana 13 zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, na osnovu Etičkog kodeksa i Korporativno upravljanje tačka 15.3 za javna preduzeća. Na osnovu Odluke br. 09/2022 Odbora direktora KMDK, sa protokolom broj 01-59/9, Preduzeće za upravljanje deponijama u Republici Kosovo ponovo saopštava:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE POSLA)

Zvanje: Glavni službenik za finansije i trezor - ZKFTH

Referentni broj: ZP/KJ-3-2023.

Izveštava: Upravnom odboru i glavnom izvršnom direktoru

Nivo plata: Nivo II.

Radno vrijeme: 40 sati sedmično.

Mandat: 3 godine sa mogućnošću produženja.

Mesto rada: Priština.

Dužnosti i odgovornosti:

Glavni službenik za finansije i trezor Kompanije (ZKFTH) upravljat će pod vodstvom i nadzorom EK, kao i dodatnim radom prema zahtjevima EK, finansijskim pitanjima Kompanije, u zavisnosti od ograničenja postavljenih od strane Upravnog odbora, ima ovlaštenje da zaključuje sve finansijske ugovore za Kompaniju i biće odgovoran za:

- Da održava račune kompanije ažurnim i tačnim;
- Uspostavljanje i upravljanje svim internim finansijskim kontrolama, uključujući kupovine, gotovinske primitke i osnovna sredstva;
- ZKFTH na glavnom nivou javnog subjekta, direktno je podređen i odgovoran glavnom administrativnom službeniku za finansijsko poslovanje, računovodstvo i sastavljanje finansijskih izvještaja javnog subjekta.
- ZKFTH je odgovoran za nadzor svih finansijskih aktivnosti subjekta javnog sektora kako bi se garantovao kvalitet i usklađenost:

završni budžetski dokument i koordinacija rada tokom procesa planiranja javnog subjekta;

periodične izvještaje za praćenje budžeta za donosioce odluka;

finansijske transakcije, računovodstveni i godišnji finansijski izvještaji javnog subjekta u skladu sa zahtjevima važećeg zakonodavstva i podzakonskih akata koje donosi ministar finansija, rada i transfera;

interni propisi upravljanja finansijama, dizajn procesa i područja rizika, obezbjeđivanje revizorskih tragova za sve procese unutar subjekta i liste finansijskih kontrola za svo finansijsko osoblje javnog subjekta.

- ZKFTH je zadužen za sprovođenje odgovornosti prema članu 8. ovog zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija;
- Praćenje obaveza i koordiniranje plaćanja računa i posebnih kupovina;
- Pregledajte troškove zaposlenih kako biste osigurali usklađenost sa korporativnim politikama i budžetom prije plaćanja;
- Pripremiti podatke kompanije za reviziju na kraju godine;
- Da koordinira druge poslovne funkcije, kao što je davanje u zakup objekata i opreme KMDK S.A.;
- Da upravlja trezorom kompanije;
- Odlučuje i priprema budžet;
- obavlja i druge dodatne poslove u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na raspoređenu poziciju;
- druge poslove koje odredi EK i uputstva BD; I
- Za svoj rad odgovara BD i EC.

Kvalifikacije i radno iskustvo:

- Univerzitetska diploma Ekonomskog fakulteta,

- Profesionalno radno iskustvo od najmanje 3 godine u oblasti finansija i računovodstva.

Ključne vještine:

- Demonstracija odličnih komunikacijskih i saradničkih vještina sa menadžmentom i osobljem kompanije;
- Poznavanje računovodstvenog programa "Quick Books".

Potrebni uslovi rada i kvalifikacije:

Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe poznatog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove prema članu 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke d, f, j, k, l i (iii) ima potrebno profesionalno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju, pod uslovom da (i) glavni službenik za finansije i trezor posjeduje univerzitetsku diplomu i značajno profesionalno iskustvo u oblasti finansija i/ili računovodstva.

Pored opštih uslova, kandidati moraju ispunjavati i ove posebne uslove:

- Poželjno je biti računovođa certificiran od strane bilo kojeg autoriteta licenciranog od strane KKRF-a ili međunarodnog,
- Poželjno je imati menadžersko iskustvo u oblasti finansija javnog sektora,
- Da poseduje znanje o tumačenju Međunarodnih računovodstvenih standarda (MRS) i Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) na osnovu kojih Društvo izveštava,
- Poznavanje stranih jezika je prednost.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični obrazac u kancelariji KMDK SHA ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji u kancelarijama KMDK SA na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakërisë". Telefon: 038/ 600 – 552.

Potrebna dokumentacija za prijavu:

- Aplikacija,
- Detaljan CV (Europass format),
- Kopija lične karte ili pasoša sa rokom,
- Motivaciono pismo,
- Kopija diploma o školskoj spremi, nostrifikacija za diplome stečene u inostranstvu;
- Dokaz o radnom iskustvu/uvjerenje o radnom stažu izdato od strane nadležnog zavoda za zapošljavanje kojim se utvrđuje radno mjesto kao i trajanje angažovanja na toj poziciji;
- Izjave o penzijskim doprinosima (ne zahtevaju se za radno iskustvo pre osnivanja Kosovskog penzijskog štednog fonda i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da plate ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa sajta Kompanije;
- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja);

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je trideset (30) kalendarskih dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u elektronskim novinama/platformama i web stranicama KMDK na <https://kmdk-ks.org/?page=1,7> prihvata dokumentaciju, od: 31.03.2023 do 01.05.2023, 08:00-16:00h.

Napomene:

Kandidati sa nekompletnom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van konkursnog roka biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju definisane kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor. Dokumentacija se dostavlja u zatvorenoj koverti.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SHA

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 552.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues